



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Arsim Special”**

**ofruar nga**

**Universiteti “ Barleti”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

Prof. As. Elisabeta Shehu (Kafia)

Prof.As.Dr. Oriola Hamzallari

Nëntor/2024

**Tabela Përmbledhëse e të dhënave**  
**Për Programin e studimit Master Profesional në “Arsim Special”**  
**Universiteti “Barleti”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Arsim Special”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UAMS nr. 508, datë 06.09.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2022-2023 4 PAE/ 1PAK v.a 2023-2024 5 PAE/1PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2022-2023 49 studentë v.a 2023-2024 80 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi Master Profesional (120 ECTS) në “Arsim Special” me dy vite akademike synon të krijojë te studentët njohuri, aftësi dhe kompetencë si në nivelin teorik ashtu edhe në atë praktik, të cilat janë të domosdoshme për edukimin, mbështetjen dhe mirërritjen e nxënësve me nevoja të veçanta si në shkollat e zakonshme, ashtu edhe në ato speciale. Ky program ofron njohuri profesionale për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta brenda shkollës (në klasa apo në njësi të veçanta për arsim special, të individualizuar), por edhe në mjedise të tjera të edukimit të fëmijëve të kësaj kategorie.

Ky program studimi është hapur bazuar në Urdhrin nr. 508, datë 06.09.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Programi është i organizuar në lëndë mësimore që vlerësohen me kredite në linjë me Sistemin Evropian të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe i përket nivelit të 7 të kualifikimeve sipas kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Ky program studimi ka gjithsej 129 studentë (49 studentë në vitin e dytë dhe 80 studentë në vitin e parë, respektivisht të regjistruar në vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024).



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Vlerësimi i jashtëm u krye në përputhje të plotë me udhëzimet e miratuara për këtë proces dhe u bazua në tre shtylla:

1. Bashkëbisedimi me stafin akademik dhe studentor të programit mësimor.
2. Vlerësimi i kritereve përkundrejt evidencave të paraqitura nga institucioni dhe bazës ligjore në fuqi.
3. Krahasimi i gjetjeve me raportin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm punoi në grup në pjesën e vlerësimit pranë IAL, më pas në mënyrë të pavarur individuale në lidhje me pikat 1 dhe 2 më sipër, dhe në përfundim, pati një proces konsultimi me qëllim diskutimin e hapur të gjetjeve, plotësimin e tyre, krahasimin mes gjetjeve individuale të ekspertëve, rishikimin e evidencave dhe në përfundim draftimin e këtij draft – raporti.

Vlen të theksohet që IAL ka paraqitur jo vetëm mungesa në evidenca – krahasuar me referimet e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, por një element formal që e vështirësoi jo pak punën e GVJ ishte edhe paraqitja në formate të pakërkueshme (PDF – fotografike) të evidencave. Në mungesë të funksionit *search* GVJ u përball me një punë voluminoze që mund të ishte evituar.

Universiteti “Barleti”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36 / 8 Prot, datë 02.10.2024. Universiteti “Barleti”, njofton në ASCAL më datë 09.00.2024, me anë të shkresës me Nr.1231 Prot, datë 09.10.2024 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1231 Prot, Datë 09.10.2024.

**GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin , sqaron si vijon:**

### **Standardi II.1., Kriteri 4.**

Së pari: në vlerësimin e GVJ, kriteri 4 kërkon pikërisht vijueshmërinë e studimeve. Rrjedhimisht, në mendimin e GVJ, duke qenë se fusha e studimit të këtij MP është mjaft specifike dhe delikate, IAL duhet ti kushtojë më shumë rëndësi këtij aspekti, nëpërmjet një studimi analitik input/output, pra të njohurive kryesore të nevojshme për të vijuar studimet në këtë program studimi.

Së dyti: në evidencën 20.6, fq. 30, kriteri i vetëm i pranimit specifikohet të jetë nota mesatare e pranimit e përcaktuar me VKM për vitin akademik 2025-2026“. GVJ vlerëson që referimet e dhëna në përgjigjen e IAL ndaj paketës së aplikimit për licencim, së paku duhet të ishin referuar edhe në RVB.

Së treti: GVJ vlerëson se përgjigja e dhënë në RVB është e paplotë dhe adreson vetëm planin mësimor, pra të asaj që studentët pritet të përftojnë por nuk merr në konsideratë përgatitjen paraprake të këtyre studentëve.

Në përfundim, GVJ vlerëson se komenti i GVJ për këtë kriter mbetet i pandryshuar dhe po ashtu edhe vlerësimi.

### **Standardi II.1, Kriteri 5 dhe 7**

Në reflektim të komentit të GVB, për të dy kriteret 5 dhe 7, GVJ thekson se e ka marrë në konsideratë evidencën nr. 4 dhe planin mësimor. Në evidencën 4 përmendet që janë analizuar planet mësimore dhe programet lëndore të programeve të ngjashme në Universitetin e Tiranës dhe atë të Vlorës si dhe janë bërë konsulta online me Universitetin “George Mason” në SHBA. Por, në vlerësimin e GVJ, ky informacion deklarativ nuk është i mjaftueshëm për të mundësuar një vlerësim të plotë dhe objektiv të përmbushjes së kriterëve dhe nuk është në detyrimet e GVJ të kryejë vlerësimin analitik me programet e ngjashme por e GVB. Një raport krahasimor i programeve lëndore – i përfshirë në evidencën 4 ose më vete, është i rekomandueshëm.

Për sa më sipër, GVJ është i mendimit që rekomandimi mbetet i vlefshëm dhe po ashtu edhe vlerësimi.

### **Standardi II.2, kriteri 3:**

GVJ thekson që vlerësimi i kriterit është bërë bazuar në hulumtimin e evidencave të dhëna dhe në rastin konkret në RVB është përmendur “urdhëri nr. 29 për emërimin e Dr. F. Kulla” ndërkohë që dokumenti i ngarkuar në sistem i referohet urdhërit nr. 26 për emërimin e Dr. A. Qafa. Për më tepër, kriteri nr. 3 kërkon që IAL “për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit”.

Në këto kushte, GVJ vlerëson që ky kriter specifik mbetet i paplotësuar dhe vlerësimi i Standardit nuk ndryshon.

### **Standardi II.4., Kriteri 5**

GVJ nuk gjen asnjë referencë rregullatore të ndalesës së përditësimit të literaturës në periudhën mes licencimit dhe akreditimit.

Për këtë arsye GVJ vijon të konsiderojë që rekomandimi për përditësimin e literaturës mbetet i vlefshëm dhe po ashtu edhe vlerësimi i dhënë.

### **Standardi II.5, kriteri 3**

Në vlerësimin e GVJ ky kriter kërkon bashkëpunimin me rrjete profesionistësh, etj, me qëllim përmirësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit dhe kjo në opinionin e GVJ synon zhvillimin e iniciativave që nxisin përmirësimin e programit dhe jo vetëm të vlerësimit të qasjes së të diplomuarve ndaj tregut të punës. Lista e marrëveshjeve në opinionin e GVJ nuk e provon realizimin e këtij qëllimi por përbën një mjet fillestar të nevojshëm. Gjithashtu, GVJ në raportin e vlerësimit nuk është shprehur “Nëse e sheh të nevojshme departamenti..” por “GVJ rekomandon që DSHETP të evidentojë dhe të nxisë më tej

shkëmbimet me aktorë të interesuar me qëllim përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen nëse është e nevojshme, të programit të studimit.”.

GVJ dëshiron të theksojë që “rekomandime të tilla” në vetvete nuk ndikojnë në vlerësim por mungesat dhe gjetjet e evidentuara ndikojnë, në shkallë të ndryshme, në nivelin e vlerësimit.

Në përfundim GVJ vijon të jetë e mendimit që komentet e bëra dhe vlerësimi respektiv i kriterit të mbeten të pandryshuara.

#### **Standardi III.2., Kriteri 1.**

GVJ thekson se ky kriter, ndër të tjera, kërkon publikimin e rregulloreve. Dhe rekomandimi i dhënë është pikërisht ky. Në përgjigjen e GVB theksohet që ky dokumentacion është ngarkuar në sistemin e ASCAL dhe që ditën e parë të vitit akademik studentët njihen me të. Duke qenë se publikimi dhe ngarkimi në sistemin ASCAL apo njohja e studentëve në ditën e parë, në opinionin e GVJ nuk janë identike, GVJ ruan të njëjtin vlerësim.

#### **Standardi III.2, Kriteri 2.**

GVJ thekson që e ka konsideruar si të plotësuar këtë kriter bazuar në syllabuset e lëndëve dhe nga bashkëbisedimi me stafin akademik. Por, referimi ndaj evidencave të gabuara apo që nuk ekzistojnë, në më shumë se një rast, ka krijuar probleme, ngarkesë dhe vonesa për GVJ.

Në këtë këndvështrim, komenti i bërë nga GVB nuk influencon në vlerësimin e dhënë nga GVJ, që mbetet i pandryshuar.

#### **Standardi III.4, Kriteri 3.**

GVJ, në përgjigje të komentit të bërë nga ana e GVB, dëshiron të përsërisë që “nuk pretendon” por evidenca e cituar mungon.

Prandaj, pavarësisht se GVJ e ka vlerësuar si të përmbushur kriterin, komenti mbi evidencën mbetet i pandryshuar dhe GVJ e rithekson si rast të përsëritur.

#### **Standardi III.4, Kriteri 4.**

Ashtu siç u përmend më lart, në RVB në disa raste ka referime të gabuara. Nëse GVB mendon se GVJ duhet të kontrollojë për çdo kriter 133 evidencat e depozituara në sistem, kjo është e pamundur.

GVJ vë në dukje se evidenca “Për projektet kërkimore” në pjesën më të madhe i referohet aktiviteteve të para çeljes së këtij programi studimesh dhe po ashtu evidenca Projekte për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, GVJ vlerëson që të ndryshohet opinioni i dhënë në draft raportin e vlerësimit për këtë kriter por kjo nuk influencon nivelin e vlerësimit, si më poshtë vijon:

GVJ, pasi shqyrtoi elementët përbërës të programit të studimit, vlerëson se mësimdhënia zhvillohet në bazë të kompetencave të përgjithshme dhe specifike, sipas karakterizimit të lëndëve. Qëllimi është t’u ofrojë studentëve mundësinë për të thelluar njohuritë dhe për ti zhvilluar ato në laboratorë dhe në praktikën profesionale. Gjithashtu, programi i studimit,

nëpërmjet bashkëpunimeve të ndryshme, i ofron mundësi praktike studentëve për të thelluar dhe aplikuar njohuritë në kontekstin praktik. Stafi akademik, siç tregohet edhe në syllabuset e lëndëve, jep mbështetje të theksuar për zhvillimin e mendimit kritik, diskutimeve dhe punës në grup. Ai krijon një atmosferë të përshtatshme për nxitjen e ideve inovative, promovon studimet kërkimore-shkencore dhe integron format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese, me qëllim të mundësimin dhe rritjes së mobilitetit të studentëve .

GVJ edhe në këtë rast vëren që RVB i referohet dy evidencave të referuara në mënyrë të gabuar duke qenë se në dokumentacionin e depozituar nuk është shënuar numri i evidencës. (Evidenca 32.f. Lista e konkurseve ne mbeshtetje te sipermanjeve rinore dhe Evidenca 32.e. Projekte te zbatuara dhe ne proces Grupi Barleti). GVJ gjithashtu vëren se dy evidencat e dhëna i referohen aktiviteteve të kryera para fillimit të këtij programi studimi (viti akademik 2022-2023); rrjedhimisht si të tilla nuk mund të merren në konsideratë.

#### **Standardi III.4, Kriteri 6.**

Ashtu si më lart, GVJ vëren se evidencat e paraqitura, por të referuara në mënyrë të pasaktë, prezantojnë aktivitete të kryera para fillimit të këtij programi studimi (viti akademik 2022-2023). Gjithashtu GVJ thekson nuk gjen evidencë të mbështetjes financiare të këtyre projekteve nga ana e institucionit.

*Për sa më lart, GVJ, sugjeron ndryshimin e komentit si më poshtë, por jo vlerësimin e kriterit që nuk ndryshon:*

GVJ vlerëson se IAL ka krijuar një strukturë solide të mbështetjes së ideve bashkëkohore të studenteve dhe iu krijon mundësi për përfshirje në projekte kërkimore e studime të avancuara nëpërmjet instituteve "UniBa". Por GVJ nuk gjen evidencë të mbështetjes financiare të këtyre projekteve.

Gjithashtu, GVJ evidenton që RVB i referohet serish evidencave të referuara në mënyrë të gabuar dhe që prezantojnë aktivitete të kryera para fillimit të këtij programi studimi (Evidenca 32.e. Projekte te zbatuara dhe ne proces Grupi Barleti, Evidenca 32.f. Lista e konkurseve ne mbeshtetje te sipermanjeve rinore)

#### **Standardi III.5, Kriteri 1.**

GVJ, bazuar pikërisht në “Rregulloren e Programit MPAS (evidenca 3, e hedhur në sistem),” ka bërë edhe konstatimin e përmendur në draft raportin e vlerësimit. POR, GVJ rithekson se ndërsa Neni 16 i kësaj Rregulloreje (referenca 3) përcakton që prova finale do të jetë në trajtën e provimit të përgjithshëm të formimit, RVB citon edhe “tezë kërkimi, një seri esesh, një projekt kërkimi, një dosje kërkimi”, për të cilat GVJ nuk arrin të gjejë një akt rregullator të brendshëm (neni 16, pika 3) dhe as publikim.

*Për sa më sipër GVJ mban, shprehet për mos ndryshimin e vlerësimit të kriterit.*

#### **Standardi III.5, Kriteri 2.**

GVJ, thekson se:



1. RVB referon Evidenca 2.4: Fondi i pyetjeve provim formimi MPAS. Dhe kjo referencë mungon. Por në dokumentacionin e depozituar gjendet Evidenca 2.4 “Programi për provim e diplomim në MPAS. Kjo për sa i përket formës.

2. Në lidhje me përmbajtjen, GVJ, në formimin minimal akademik që e karakterizon, gjithsesi arrin të kuptojë që “niveli i studimit master kërkon të vlerësohen kompetencat e përfituara, që programi orientues i pasqyron më së miri”. POR, GVJ vëren se ky program orientues është shumë i ngjashëm me Programet lëndore – syllabuse (evidenca 2.6) që është një listim i titujve të temave për çdo lëndë.

Për sa më sipër, GVJ vlerëson që të ndryshojë komentin por jo vlerësimin e këtij kriteri si më poshtë vijon:

GVJ vlerëson nga bashkëbisedimi me stafin akademik dhe me studentët që strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Po kështu, nga evidencat e paraqitura GVJ vlerëson se njësia përgjegjëse ka krijuar tashmë një strukturë dhe proces të asistimit të studentëve.

Por, GVJ vëren që evidenca 2.4 referuar në mënyrë të gabuar nga RVB si “Fondi i pyetjeve provim formimi MPAS”, gjendet nën emërtimin “Programi për provim e diplomim në MPAS” dhe përbën një listim të titujve të temave për çdo lëndë – informacion i cili gjendet edhe në syllabuset e lëndëve.

#### **Standardi IV. 1, kriteri 1.**

Përsa i përket komentit që është cituar evidenca e një departamenti tjetër, konfirmohet që ka pasur një gabim në citimin e referencës “Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit”, por analiza është bërë duke u bazuar tek dokumenti “Lista e plotë e stafit akademik i Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2025”, pavarësisht se në raport është cituar gabim. Në këtë dokument vihen re lëvizjet e stafit akademik (M.K., O.M., F.SH.) të departamentit, që përbën mbi 30% të stafit efektiv, por për stafin akademik që është i angazhuar në programin studimor kjo lëvizje është më pak se 30%. Gjithashtu, dëshiroj të qartësoj se qëllimi i vlerësimit nuk ka qenë që të nënkuptohet se stafi nuk është i kualifikuar për të dhënë mësim në këtë program, por disa anëtarë të stafit akademik të departamentit kanë profile të ndryshme nga fusha e edukimit dhe arsimit special, që është fusha primare e programit studimor. Konstatimi që pedagogët A.R dhe E.M. nuk japin mësim në këtë program është korrekt, por këto pedagogë janë angazhuar në dhënien e lëndëve jashtë profilit të tyre, si p.sh. A.R. në kursin zhvillim programi dhe politika arsimore, dhe E.M. në kurse si psikologji komunikimi, aftësi studimore dhe punësimi, marketing për turizmin, evente dhe mikpritje. Nga ana tjetër, O.M. e angazhuar në programin studimor MP “Arsim Special”, jep kursin e Filozofisë së Edukimit, jashtë profilit të saj të studimeve. Qëllimi i këtij komenti është bërë në mënyrë konstruktive, që të ketë përputhje midis profileve të stafit akademik dhe nevojave të departamentit, e gjithashtu të këtij programi studimor si për shembull në rastin e F.K apo A.ZH. Sërish, dëshiroj të qartësoj se analiza





që 23% e pedagogëve në këtë program kanë qenë me Msc, është analizë e stafit akademik të departamentit<sup>1</sup>. Ky konstatim është bërë për të reflektuar se stafi akademik në përqindje të lartë është me gradë shkencore dhe me tituj akademik, ky konstatim nuk është përdorur për vlerësim më të ulët të këtij kriteri. GVJ për të bërë vlerësimin e Standardit IV.1, është bazuar tek cënimi i qëndrueshmërisë së stafit akademik, si në nivel departamenti por edhe në nivel të programit studimor. Në nivel departamenti ky ndryshim reflektohet me mbi 30% të stafit që është larguar. Në nivel të programit studimor, komenti i GVB-së është korrekt, vetëm M.K është larguar, një ndryshim prej 25% e stafit, pasi në total 4 pedagogë kanë qenë të angazhuar, pra nuk cënohet qëndrueshmëria e stafit akademik për programin studimor. GVJ rivlerëson pikëzimin për Standardin IV.1 nga 2 që është vlerësimi aktual në 3.

### **Standardi IV.1, kriteri 2**

Në lidhje me ngarkesën mësimore, mbas rishikimit sërish të tabelës 1 dhe 2, konstatojmë se këto tabela lidhen me personelin PAE, PAK, PNA dhe PA, por jo me ngarkesat mësimore. Tabela 4 dhe Tabela 12 janë tabela që mund të merren të dhëna për ngarkesat në programin studimor të stafit të angazhuar në të (Tabela 12) si dhe të dhëna për ngarkesën totale vjetore të stafit akademik që angazhohet në programin e studimit (Tabela 4). Përkatësisht, në tabelën 4 mungojnë të dhënat e angazhimit të stafit akademik në programet e tjera, por jepen vetëm të dhëna për ngarkesën në programin studimor dhe vetëm për vitin akademik 2023-2024. Gjithashtu, GVJ konfirmon se në tabelat 12 për planin mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës, për vitin akademik 2022-2023, nuk jepen të dhëna, ndërsa për vitin akademik 2023-2024, ngarkesat mësimore për planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës nuk janë të plota. Për këtë arsye GVJ ka kërkuar tabelat sërish për të qartësuar ngarkesën vjetore të stafit akademik që është i angazhuar në këtë program studimor.

### **Standardi IV.1, Kriteri 3**

GVJ mbas rishikimit të Kriterit 3, të Standardit IV.1., del në konkluzionin se lëvizshmëria e stafit akademik nga viti akademik 2022-2023, në vitin akademik 2023-2024, për programin e studimit, është më pak se 30%, duke mos cënuar qëndrueshmërinë e stafit për këtë program, por në nivel stafi akademik të departamentit, përqindja e lëvizshmërisë së stafit akademik është mbi 30%. Përsa i përket konstatimit të GVJ se kontratat për staf akademik me grada/tituj, kontratat janë të pacaktuara, ky konstatim konfirmon që këto kontrata të lidhura në kohë të pacaktuar janë në përputhje me kuadrin ligjor.

### **Standardi IV. 1, Kriteri 6**

GVJ vlerëson sqarimin në lidhje me konfidencialitetin për informacionin rreth pagave në kontratat e punës dhe fleksibilitetin e pagave në UniBa. GVJ kupton rëndësinë e detajeve rreth pagave dhe se këto paga rishikohen periodikisht në varësi të performancës. Gjithsesi, si një kërkesë ligjore, çdo kontratë pune duhet të specifikojë pagën. GVJ vlerëson se kontratat e punës

<sup>1</sup> Shih evidencën "Lista e plotë e stafit akademik i Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2022-2025"



duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe vlerëson transparencën për pagat. Përcaktimi i pagesës edhe pse në një seksion të veçantë konfidencial, duhet të jetë prezent në kontratën e punës. Gjithashtu, në DVV nuk gjenden evidenca që konfirmojnë këtë seksion specifik të përcaktimit të pagës, por edhe gjatë vizitës në institucion, kjo evidencë dhe evidenca e rritjes së rrogës për pedagogë me performancës të lartë, nuk u demonstruan nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Pavarësisht se GVJ kupton fleksibilitetin e institucionit për të përcaktuar pagat e stafit akademik bazuar në burimin kryesor ekonomik që lidhet me regjistrimin e studentëve, mungesa e evidencave vështirëson vlerësimin e plotë të praktikave që përdoren nga UniBa për kompensimin e drejtë të stafit akademik. Gjithashtu, si një institucion i arsimit të lartë jo publik, GVJ mirëkupton që pagat ndikohen nga burime financiare që lidhen drejtpërsëdrejti me regjistrimet e studentëve. GVJ shpreh shqetësim në lidhje me dallimin e rëndësishëm të pagave ndërmjet UniBa dhe universiteteve publike, që në disa raste janë pothuajse dyfish më të larta në universitetet publike. Ndërkohë që GVJ mirëkupton këtë fleksibilitet në paga që vjen nga burime të kufizuara financiare, këto dallime mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti motivimin e stafit akademik. Si rrjedhojë, GVJ beson se krijimi i një dokumenti që përcakton kategoritë e pagave të stafit akademik, kriteret e vlerësimit të performancës që krijojnë mundësinë për një rritje të pagesës, evidentimin dhe dokumentimin e pagave, do të rrisë transparencën e vlerësimit dhe mund të nxisë stafin akademik të kualifikuar të ketë një angazhim afatgjatë.

#### **Standardi IV. 3, kriteri 1**

GVJ vlerëson komentet në lidhje me literaturën që përdoret në silabuset e programit studimor, përkatësisht komentet që vlerësojnë literaturën e viteve të mëparshme kur UniBa ka marrë licencimin e programit studimor, e se kjo literaturë ka qenë bazë për suksesin e programit. Gjithsesi, disiplinat e arsimit special avancojnë dhe është e rëndësishme që vazhdimisht të përditësohet literatura duke reflektuar kërkime të reja dhe standarde akademike bashkëkohore. GVJ kupton këtë sfidë të vështirë të përditësimit të literaturës me libra akademikë të pesë viteve të fundit dhe e vlerëson që silabuset janë përditësuar mbas vizitës në institucion, ku në disa prej tyre është ndryshuar literatura dhe janë vënë ribotime të librave më të fundit në gjuhën shqipe. Përtej këtyre sfidave në përditësimin e literaturës, GVJ konstaton se një pjesë e silabuseve në literaturën bazë, kanë cikël leksionesh të përgatitura nga pedagogët përkatës por pa referuar literaturën përkatëse. Gjithashtu konstatohet se literatura e rekomanduar është më shumë e orientuar nga vitet 2000-2010. Në dy silabuse literatura është e njëjtë, e në disa silabuse literatura bazohet në manuale, udhëzime, apo libra të shkruar nga praktikues të fushës por që nuk plotësojnë kriteret e tekstit akademik. GVJ vlerëson komentet për bibliotekën dhe mjediseve që i ofrohen studentëve për të shfletuar librat. GVJ vlerëson sqarimet rreth bibliotekës online, bibliotekës lëvizëse, hapësirave fizike të bibliotekave, në të cilat mbahen dhe leksione e seminare. GVJ konfirmon që Koordinatori Institucional ka vëzhguar këto mjedise dhe vlerësojmë gjykimin e koordinatorit në këtë proces. Gjithsesi, për GVJ është me rëndësi të theksojë se vlerësimi ynë bazohet në vëzhgimin e këtyre mjediseve, vizitës me përgjegjësin e bibliotekës, dhe përvojave të studentëve dhe stafit akademik gjatë vizitës. GVJ i vlerëson platformat digjitale aktuale që ofron UniBa për menaxhimin e librit. GVJ është e shqetësuar për rigozitetin e këtyre librave që ofrohen më së shumti në gjuhën shqipe dhe nuk janë libra akademikë. Mungesa e librave akademikë në përputhje me programin studimor, mungesa e dorëzimit të leksioneve në bibliotekë ngre një shqetësim aktual për cilësinë e materialeve



mësimore. Për më tej, natyra jo formale e sistemit Google Classroom, edhe pse shërben për komunikim efektiv, nuk garanton të njëjtin nivel përgjegjshmërie si një platformë formale e burimeve të bibliotekës. Vëzhgimi i GVJ tregon se hapësira fizike është e kufizuar, sidomos për studentë që duan të shfletojnë literaturë e të lexojnë në qetësi. Për më tepër, integrimi i hapësirave të bibliotekës me mjedise të tjera mund të krijojë mjedise me zhurmë, duke ndikuar procesin e studimit tek studentët ose duke mos pasur motivacion të mjaftueshëm për të përdorur këto hapësira. GVJ e vlerëson ruatjen e literaturës së viteve të mëparshme, pasurimin e bibliotekës me një larmi librash, por gjithashtu vlerëson që të përfshihen tekste akademike të përditësuara për programin studimor që nxisin mbështetjen e studentëve për literaturë të përditësuar. GVJ e vlerëson përpjekjen e vazhdueshme të UniBa dhe angazhimin në përmirësimin e burimeve të bibliotekës. Vlerësimi i bërë nga GVJ është një mundësi për të rritur kontributin e vazhdueshëm të UniBa për ruatjen e standardeve të larta në ofrimin e programit studimor duke pasuruar dhe përmirësuar përvojën e studentëve të programit studimor.

#### **Standardi 4.5**

GVJ vlerëson sqarimin në lidhje me auditimin e institucionit dhe sqarimet për të gjetur rezultatet e auditimit të jashtëm duke shkuar tek faqja zyrtare e kompanisë së auditimit, dhe se si të shohim vlerësimet e auditimit të brendshëm. GVJ konstaton se dokumenti i auditimit të jashtëm nuk është si evidencë dhe nuk gjendet sipas udhëzimeve për ta kërkuar tek faqja e kompanisë së auditimit. Për arsye transparence dhe përgjegjshmërie të tilla auditime duhet të jenë të aksesueshme nga vlerësuesit e jashtëm, pasi luajnë një rol të rëndësishëm për të kuptuar praktikatat financiare të institucionit. GVJ gjatë analizës së këtij kriteri është bazuar në dokumentin e referuar në koment, dhe ka vlerësuar në përputhje me tabelat financiare, dhe ka arritur në konkluzionin se burimi më i madh financiar garantohej nga regjistrimi i studentëve. GVJ e pranon që kjo është një praktikë e shpeshtë në institucionet e arsimit të lartë, por shpreh shqetësim në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, pasi mbështetja vetëm tek regjistrimet e studentëve si një burim parësor financiar është sfiduese dhe e paparashikueshme nën kushtet e një tregu të paqëndrueshëm. Gjithashtu, 5.7% e buxhetit shkon për aktivitete kërkimore dhe blerje librash, 2.2% për projekte dhe 3% për teknologji në mësimdhënie, duke sugjeruar se këto burime janë të kufizuara për të nxitur ofertën akademike dhe për të mbështetur zhvillimin e stafit akademik. Për këtë arsye GVJ rekomandon një plan strategjik për qëndrueshmërinë financiare të institucionit duke rritur burimet e të ardhurave financiare dhe duke krijuar prioritete në kërkim. GVJ vlerëson përpjekjet e auditimit të brendshëm dhe transparencën e shfaqur për tabelat financiare. GVJ shpreson që duke u bazuar në këto vlerësime, do të mbështesim institucionin në nxitjen e mjediseve të qëndrueshme financiare që i japin prioritet ekselencës akademike.


#### **Fusha V. Studentët dhe mbështetja e tyre**

##### **Standardi 5.1, kriteret 3, 4, 5**

GVJ vlerëson informacionet e detajuara në lidhje me edukimin e studentëve që janë angazhuar në programin studimor MP Arsim Special. Siç është parashikuar nga aktet ligjore<sup>23</sup> nga viti

<sup>2</sup> Vendim Nr. 46, datë 27.1.2021 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf>

<sup>3</sup> Vendim Nr. 436, datë 3.6.2020 [https://ualbania.al/theme/files/vendim-2020-06-03-436\\_perditesuar.pdf](https://ualbania.al/theme/files/vendim-2020-06-03-436_perditesuar.pdf)



akademik 2020-2021 dhe në vijim përcaktohet mesatarja minimale 7.5. GVJ është dakord që ligji nuk ka fuqi prapavepruese, por nga ana tjetër aktet ligjore për kriterin e mesatares nuk përcaktojnë përjashtimin e këtyre studentëve që kanë një licencë në mësuesi, por të cilët dëshirojnë të studiojnë për të marrë një specializim në arsimin special. Edhe pse këto studentë kanë hyrë në program me kualifikime në mësuesi, ato për vitet akademike që janë regjistruar në programin studimor duhet të plotësojnë kriterin e mesatares pikërisht për këtë specializim të ri në mësuesi që dëshirojnë të arrijnë, duke respektuar integritetin e programit studimor dhe të jenë në përputhje me standardet kombëtare për programet e mësuesisë. GVJ rekomandon që të merren masa në vitet në vazhdimësi që të ruhet mesatarja sipas akteve ligjore, duke ruajtur standardin e nevojshëm për akreditim të programit mësimor. GVJ vlerëson angazhimin e UniBa për të mbështetur profesionistët me përvojë në fushën e mësuesisë dhe inkurajon përputhshmëri të pranimeve të ardhshme sipas akteve ligjore në fuqi.

#### **Standardi 5.1, kriteri 7**

GVJ vlerëson sqarimin e dhënë nga GVB për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Ky sqarim përforcon vlerësimin e GVJ për kriterin përkatës.

#### **Standardi 5.1, kriteri 8**

GVJ vlerëson qartësimin e mëtejshëm për politikat institucionale në lidhje me kriteret për marrjen e bursave për studentët që kualifikohen për të marrë këto bursa. GVJ vlerëson angazhimin institucional për garantimin e bursave për studentë të kategorive specifike duke u bazuar në kritere të meritokracisë por edhe duke u bazuar në kushtet socio-ekonomike të vështira të një grupi specifik të studentëve. Gjithsesi, vëzhgimi që jo vetëm në programin studimor por edhe në programe të tjera nuk ka evidenca që studentët e kategorive specifike nuk kanë fituar bursa, reflekton që politikat në mbështetje të bursave të studimit nuk janë implementuar. GVJ shprehet se edhe në rastet kur asnjë student nuk plotëson kriteret e përcaktuara, dokumentimi i aktiviteteve të komisionit për dhënien e bursave si dhe vlerësimi i kandidatëve të mundshëm duhet të referohen në mënyrë që të ruhet transparencja e procesit. GVJ rekomandon që UniBa të dokumentojë të gjithë procesin e komisionit për dhënien e bursave studentore edhe kur nuk jepen bursat, në mënyrë që të jetë në përputhje me standardet e akreditimit.

#### **Standardi 5.4, kriteri 1, 5**


GVJ shpreh qëndrimin e saj në lidhje me kriterin e mesatares si në **Standardin 5.1, kriteri 3, 4, 5**. Kërkesa për kriterin e mesatares është një detyrim ligjor për të gjitha institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe të studimit master në mësuesi. Ky kriter ka si qëllim të ruajë standarde të larta akademike gjatë këtij specialiteti. GVJ respekton përjashtimin e GVB, por nga ana tjetër thekson se ruajtja e standardit të kriterit të mesatares është kritike për të ruajtur cilësinë e programit. Në lidhje me kriterin 5 të Standardit 5.4, GVJ shpreh vlerësimin që kjo çështje është adresuar nga GVB. GVJ vlerëson komentet dhe shqetësimet e studentëve dhe perspektivën e tyre në mënyrë që përmirësimi i programit të jetë i vazhdueshëm. Pavarësisht, se roli i ndihmës mësuesit mund të jetë sinonim me rolin e mësuesit të arsimit special në kontekstin tonë, terminologjia e përdorur ndikon në mënyrë të rëndësishme perceptimin e studentëve në rolin e tyre si mësues në fushën e arsimit special. GVJ pranon dhe mirëkupton që UniBa nuk ndikon



drejtpërsëdrejti në ndryshimin e kësaj terminologjie, por bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe reflektimi i problematikave të tilla mund të ndihmojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në rivlerësimin/përmirësimin e terminologjisë duke reflektuar kualifikimin, aspiratat dhe identitetin profesional përkatës të studentëve.

### **Kthim përgjigje pikave tek përfundimi**

GVJ vlerëson GVB për komentet, analizën, reflektimin e shqetësimeve në lidhje me procesin e vlerësimit të programit studimor, pasi këto komente qartësojnë procesin e vlerësimit dhe mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të këtij procesi. GVB shpreh paqartësi në modelin e vlerësimit të GVJ. Në falenderojmë GVB për këtë shqetësim të tyre, pasi i jep mundësi GVJ të qartësojë përfaqshën në vlerësim. GVJ shpreh se ka përdorur elementë të modelit holistik dhe analitik, duke u fokusuar tek efikasiteti i programit sipas standardeve përkatëse dhe kriterëve specifike të këtyre standardeve, dhe më pas është bërë një vlerësim final tërësor për programin studimor. Kjo përfaqshje lejon të vlerësohen aspekte të ndryshme të programit studimor sipas standardeve të akreditimit. Përsa i përket instrumentave specifike të përdorura, GVJ ka përdorur instrumenta cilësorë përgjatë intervistave në institucion dhe tregues sasi kur ka qenë e mundur aplikimi i këtyre treguesve. Secili standard është vlerësuar në një shkallë Likert nga 1 deri në 4. Nga ana e GVJ është bërë maksimumi për të dhënë një vlerësim sa më objektiv duke marrë në konsideratë jo vetëm evidencat shkresore të depozituara por edhe intervistat dhe bashkëbisedimet e kryera dhe madje janë bërë edhe kërkime në faqen web të UniBa për të gjetur evidencë kur këto nuk ishin referuar në RVB. GVJ ka zbatuar me rigorozitet vlerësimin analitik dhe holistik, në raport me kriteret formale, dhe në vlerësimin e çdonjërit standard ka marrë në konsideratë të gjithë treguesit e plotësimit të kriterëve të veçanta. GVJ në vlerësimin final ka vlerësuar programin studimor me pikëzimin 3, një pikëzim që tregon se programi kryesisht plotëson standartet e akreditimit. GVB arrin në konkluzione të nxituara nëse mendon që shkallët e vlerësimit janë zbritur thjesht nga mungesa e një evidence. GVJ ka marrë në konsideratë si anët pozitive, ashtu edhe ato më pak pozitive dhe negative, por ka vlerësuar edhe ato aspekte të përsëritura të referencave të gabuara apo të munguara. Logjika e vlerësimit është bazuar tërësisht në objektivizmin e vlerësimit të arritjes së objektivave të përcaktuara nga kriteret dhe standardet, në frymë të kuadrit ligjor dhe objektivave dhe politikave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të institucionit të ASCAL. Ky pikëzim tregon se programi ka hapësirë për përmirësim në vazhdimësi për të plotësuar plotësisht standartet e akreditimit. GVJ kupton shqetësimin e GVB që ky pikëzim mund të duket i paqartë, por pikëzimi është një tregues i angazhimit të vazhdueshëm për ruajtjen e cilësisë së programit studimor. GVJ qartëson se vlerësimi është një përpjekje për të krijuar një balancë midis përparësive të programit dhe fushave ku ka nevojë për përmirësim. GVJ vlerëson pozitivisht aspekte të reflektuara në standartet e akreditimit për programin studimor, pikëzimi final 3 është influencuar nga disa dobësi specifike të programit studimor, të lidhura sidomos me kriterin e mesatares, kushtet e punës së stafit akademik, qëndrueshmërinë financiare, mos koherencën apo mungesën e dokumentave specifik. Në vlerësojmë angazhimin institucional për të përmirësuar programin studimor. GVJ nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë arsye që të mbajë apo shfaqë standarde të ndryshme në takimet me përgjegjësin e departamentit, stafin apo studentët kundrejt draft raportit të vlerësimit. GVJ gjithashtu dëshiron të theksojë dhe të rikonfirmojë që përgjithësisht ka një vlerësim pozitiv për programin e studimit duke u shprehur që shkalla e përmbushjes së standardeve varion nga përmbushet kryesisht në përmbushet



plotësisht. Nëse departamenti dhe grupi hartues i RVB i kanë ndërtuar pritshmëritë mbi vlerësimin bazuar në kritere të tjera, kjo gjithsesi nuk çënon objektivizmin dhe profesionalizmin e GVJ. Gjatë vizitës GVJ ka vlerësuar maksimalisht përkushtimin e stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ, stafit drejtues dhe studentëve. GVJ këtë vlerësim e ka shprehur si një pikë e fortë e institucionit. Në përfundim, GVJ shprehet se vlerësimi i programit studimor MP “Arsim Special” është një mundësi bashkëpunimi për të rritur më tej cilësinë e programit studimor.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Arsim Special” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Barleti”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron</b>	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit nuk vërehen konflikte me interesat kombëtare. Nga hulumtimi i dokumentacionit



programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	me shkrim por dhe nga bashkëbisedimi me stafin dhe të interesuarit e konfirmojmë se programi në fjalë është në rezonancë të plotë me qëllimet e Institucionit dhe tërësisht në frymën e interesave kombëtare. Programi specifikisht është në shërbim të frymës së Konventave që shteti ynë ka ratifikuar në mbështetje të më të mirës së fëmijës, specifikisht të fëmijëve me nevoja të veçanta <sup>4</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si, “Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030”, "statuti", "rregullorja", si dhe nga biseda me stafin, GVJ konfirmon që programi jo vetëm ruan vlerat kombëtare por dhe priret dukshëm drejt konsolidimit të tyre <sup>5</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Vlerësohet që programi i studimit Master Profesional në “Arsim Special“ është hartuar në përputhshmëri me qëllimet e institucionit, misionin e fushën e veprimtarisë <sup>67</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ vlerëson se qasja e programit të studimit ndaj aspektit të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar është gjithëpërfshirëse dhe e bazuar. <sup>8</sup>

<sup>4</sup> Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit FSHSTS

Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti

Evidenca 1.2 Rregullore e UniBa

Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Evidenca 2.1.b “Plani Mësimor“

<sup>7</sup> Evidenca nr. 10 “Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030”

<sup>8</sup> Evidenca nr. 4 „Analiza e Tregut të Punës“

<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson se ky program studimi ofrohet tërësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij të IAL.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Master Profesional në Arsim Special ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP), Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (FSHSTS). DSHETP ka një përvojë të konsoliduar në më shumë se 10 vjet në përgatitjen e mësuesve, sidomos në programet lëndore pedagogjike. FSHSTS, nëpërmjet Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, mbulon më së miri lëndët e karakterit psikologjik, duke ofruar në kompleks formimin e duhur në përgatitjen e mësuesve ndihmës në të gjithë ciklet e arsimit parauniversitar. Nga shqyrtimi i CV-ve të pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, mbështetja financiare për kërkimin shkencor, struktura mbështetëse e institucionit, dhe bashkëbisedimet e kryera, GVJ vlerëson që institucioni demonstroi se ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi <sup>9</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit,	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MP "Arsim Special" vlerësohet nga GVJ të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, <b>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit</b> , përgjegjëse për programin e studimit. GVJ vlerëson se fusha e pedagogjisë është një ndër shkencat shoqërore më të rëndësishme dhe kjo gjen një

<sup>9</sup> Evidenca 6 Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirise akademike dhe financiare  
Evidenca 7.2 CV e stafit  
Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 - 2030 (përditësuar janar 2024)  
Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhese në MP Arsim Special



sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	konfirmim të gjerë dhe të gjithëpranuar edhe në politikat UNESCO <sup>10</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Master Profesional në Arsim Special ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale nëpërmjet Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional që në fokusin e punës akademike dhe kërkimore ka edhe aspektin pedagogjik. Ndërkohë, pjesë e këtij fakulteti është edhe Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, që mbulon më së miri lëndët e karakterit psikologjik. Kështu, në kompleks ky program studimi ofron formimin e duhur në përgatitjen e mësuesve ndihmës në të gjithë ciklet e arsimit parauniversitar. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit MP Arsim Special vlerësohet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, përgjegjëse për programin i studimit <sup>11</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	NA
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ vlerëson se kriteri I.5. përmbushet më së miri duke qenë se IAL Barleti, nëpërmjet Akademisë Barleti, ofron një numër kursesh me rëndësi të veçantë për fushën specifike të programit të studimit MPAS <sup>12</sup> () si “Trajtim për mësuesit ndihmës në shkollë”, “Trajtime ASCAP për Aftësinë e Kufizuar”, “Metoda të përfshirjes efektive të fëmijëve në spektrin e çrregullimeve autike në klasa gjithpërfshirëse”, etj.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se Programi i studimit MPAS është në përputhje të plotë dhe koherente me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Vlen të</i>

<sup>10</sup> <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000216670>

<sup>11</sup> Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit FSHSTS

Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 - 2030 (perditësuar janar 2024)

Evidenca Aneks Tabelat Permbledhese ne MP Arsim Special

<sup>12</sup> <https://bttc.umb.edu.al/akademia-edukimit-dhe-mesimdhënies/#>

	<i>theksohet si faktor tejet pozitiv ofrimi i trajnimeve profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	IAL ka krijuar grupe pune për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, dhe siguron një proces të rregulluar dhe të konsoliduar nëpërmjet ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiwe <sup>13</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	IAL ka vendosur ura të qenësishme bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit për të garantuar realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, si p.sh. me Institutin e Nxënësve që nuk dëgjojnë, Shoqatën kombëtare shqiptare të njerëzve që nuk dëgjojnë, Bashkinë Tiranë, Qendrën Johnatan, etj. Me rëndësi të përmendet është angazhimi serioz i IAL në kuadrin e ERASMUS+, nëpërmjet programeve Katedra Jean Monet dhe Katedra UNESCO. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan Zyra e projekteve ndërkomëtare dhe Erasmus + <sup>14</sup> .

<sup>13</sup> Evidenca 1 Rregullore e Fakultetit FSHSTS

Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave te Edukimit dhe Trajnimit Profesional

Evidenca 10.1. Strategjia e nderkombetarizimit

Evidenca 16.2. Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësiwe

<sup>14</sup> Evidenca 22. Lista e Marreveshjeve

Evidenca 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +

<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vëren që IAL ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione (Bashkia Tiranë), qendra të specializuara (Instituti i Nxënësve që nuk dëgjojnë), shkolla, etj. për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. Nga shqyrtimi i evidencave të paraqitura GVJ vëren se IAL ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi që përcaktojnë kuadrin proceduarial të kryerjes dhe mbikëqyrjes së praktikës mësimore për këtë program studimi<sup>15</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga bashkëbisedimet e kryera GVJ vëren së Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, si stafi akademik ashtu edhe studentët, vlerësojnë lart eksperiencën e përfutur nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit. Por, nga hulumtimi i dokumentacionit nuk rezulton asnjë raport analitik mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që njësia bazë të analizojë dhe të përgatisë raportin mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi I.3. përmbushet në pjesën më të madhe të tij duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me palë të treta si institucione, kompani, aktorë të biznesit në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. E vetmja mangësi e evidentuar është mungesa e analizës së ecurisë dhe përfitimit nga këto bashkëpunime.</i></p>

<sup>15</sup> Evidenca 2.3 Paketa e praktikës  
Evidenca 22. Lista e Marrëveshjeve

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1											
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura dhe nga bashkëbisedimet e kryera pranë IAL, GVJ vlerëson që programi i studimit MP në “Arsim Special” është organizuar në lëndë e module dhe vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program studimi vlerësohet që përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënies, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, kodi i lëndës, etj.</p> <p>Plani mësimor, i programit të studimit MPAS, i ka lëndët e grupuara sipas veprimtarisë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Veprimtaria mësimore</th> <th>Kredite (në%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>lëndë bazë</td> <td>15-20%</td> </tr> <tr> <td>lëndë karakterizuese</td> <td>50-55%</td> </tr> <tr> <td>lëndë ndërdisiplinore/integruese</td> <td>12-15%</td> </tr> <tr> <td>lëndë plotësuese</td> <td>10-15%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi<sup>16</sup>.</p>	Veprimtaria mësimore	Kredite (në%)	lëndë bazë	15-20%	lëndë karakterizuese	50-55%	lëndë ndërdisiplinore/integruese	12-15%	lëndë plotësuese	10-15%
Veprimtaria mësimore	Kredite (në%)										
lëndë bazë	15-20%										
lëndë karakterizuese	50-55%										
lëndë ndërdisiplinore/integruese	12-15%										
lëndë plotësuese	10-15%										

<sup>16</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e UniBa

<p><b>Kriteri 2.</b>Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ vëren që programi i studimit MPAS synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e edukimit dhe formimit të mësuesve në aspektin e trajtimit të nxënësve me nevoja të veçanta. Ky program studimi ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara, jo vetëm në aspektin teoriko-akademik por edhe atë praktik dhe profesional – të domosdoshme për trajtimin e problemeve komplekse të procesit të mësimdhënies me nxënës me nevoja të veçanta<sup>17</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në vlerësim të planit mësimor nga ana e GVJ konfirmohet qartazi që programi i studimit MPAS parashikon ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale dhe ekuivalentimin sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p> <p>Ky program studimi vlerësohet që përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënjes, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, kodi i lëndës, etj.</p> <p>Praktika ka 12 kredite (270 orë gjithsej : 250 orë praktikë dhe 20 orë për përgatitjen e raportit)<sup>18</sup>.</p>

Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional

Evidenca 2.1 b. Plani mesimor

Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mesimor

Evidenca 2.6 Programe lëndore-Sylabuse

Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

<sup>17</sup> Evidenca 2.1 b. Plani mesimor

Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mesimor

Evidenca 4 Analiza e tregut të punës

<sup>18</sup> Evidenca 2.1 b. Plani mesimor

Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mesimor

Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

21

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nga studimi i thelluar i programit mësimor dhe nga bashkëbisedimi me përfaqësues të stafit akademik dhe atij studentor GVJ vlerëson që ky program studimi ofron njohuri të përparura në fushën e psikologjisë së edukimit dhe të arsimit special në veçanti.</p> <p>GVJ, referuar dokumentacionit shkresor<sup>19</sup> vëren që nuk ka evidencë shkresore të mjaftueshme për sa i përket vijueshmërisë së programeve lëndore të ciklit të parë Bachelor.</p> <p><i>GVJ rekomandon përpilimin e një raporti vlerësimi të aspektit plotësues të këtij programi në vijim të studimeve të ciklit të parë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>GVJ vëren se plani mësimor, i programit të studimit MPAS, i organizuar me 120 kredite, i ka lëndët e grupuara sipas veprimtarisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lëndë bazë;</li> <li>• lëndë karakterizuese;</li> <li>• lëndë ndërdisiplinore/integruese;</li> <li>• lëndë plotësuese;</li> <li>• detyrime përmbyllëse.</li> </ul> <p>Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Nga 10 lëndët bazë të përcaktuara në kurrikul, të paktën 5 prej tyre (ose 50%) i përkasin fushave të pedagogjisë ose psikologjisë.</p> <p>GVJ vëren se nuk ka evidentim të mjaftueshëm shkresor të përputhshmërisë lëndore (prej 80%) me programe “Master” të ngjashme, referuar evidencave të dhëna<sup>20</sup>.</p> <p><i>GVJ rekomandon kryerjen e një raporti krahasimor me kurrikulat e programeve të ngjashme master.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë</p>	<p>GVJ konstaton që organizimi i studimeve, regjistrimi i studentëve dhe financimi realizohen në përputhje me ligjin nr. 80/2015</p>


<sup>19</sup> Evidenca 20.6 Vendimet për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve

<sup>20</sup> Evidenca 4 “Analiza e tregut të punës”

<p>me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Por ky kriter nuk aplikohet për Universitetin Barleti që nuk ka status të veçantë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka kryer hulumtime të thelluara mbi programe master të së njëjtës fushë studimi (Master shkencor në pedagogji speciale – Universiteti i Vlorës (120 kredite – 2 vjet) dhe Master profesional “Pedagogji e specializuar sociale” (60 kredite, 1 vit)) por nuk ka evidentuar mjaftueshëm aspektin e përputhshmërisë së lëndëve (të paktën 70%)<sup>21</sup>.</p> <p><i>GVJ rekomandon që njësia bazë të hartojë një raport analitik mbi nivelin e përputhshmërisë së përmbajtjes me programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ konfirmon që ky program studimi<sup>22</sup> i referohet Kornizës 7 të kualifikimit dhe merr në konsideratë që IAL i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në formën dhe afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.31, datë 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Konkretisht, GVJ rekomandon:</i></p>

<sup>21</sup> Evidenca 4 Analiza e tregut të punës

<sup>22</sup> Evidenca 45. Kodifikimi i programeve



	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>përpilimin e një raporti vlerësimi të aspektit plotësues të këtij programi në vijim të studimeve të ciklit të parë. (kriteri nr. 4)</i></li> <li>2. <i>kryerjen e një raporti krahasimor me kurrikulat e programeve të ngjashme master. (kriteri 5)</i></li> <li>3. <i>hartimin e një raport analitik mbi nivelin e përputhshmërisë së përmbajtjes me rogramet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi. (kriteri 7)</i></li> </ol>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.2</b>																		
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>																		
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																	
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>GVJ konfirmojnë që njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Mater Profesional në “Arsim Special” përmbush detyrimet ligjore dhe konkretisht:</p> <p>VKM Nr. 418, datë 10.05.2017: “Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik”. Ky kusht plotësohet në bazë të evidences së dhëna<sup>23</sup>.</p> <p>Gjithashtu, GVJ vlerëson se kriteret e vendosura në VKM 418 datë 10.05.2017 për raportin personel akademik me kohë të plotë / student (1:45) plotësohet.</p> <p><b>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit për dy vite akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 ka në strukturën e tij këto të dhëna</b></p>																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në FSHSTS</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Personeli i angazhuar në FSHSTS	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK								
Personeli i angazhuar në FSHSTS	2022-2023		2023-2024															
	PAE	PAK	PAE	PAK														

<sup>23</sup> Aneks Tabelat Permbledhese ne MP Arsim Special



Prof Dr	1	1	1	1
Prof.Assoc	4	3	5	4
Dr/Doc	12	12	13	23
Msc	19	18	19	13
<b>Në total</b>	<b>36</b>	<b>34</b>	<b>38</b>	<b>41</b>

**Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional ka në përbërje të tij për dy vite akademike 2022-2023 dhe 2023-2024:**

Personeli i angazhuar në DSHETP	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-
Prof.Assoc	1	-	2	-
Dr/Doc	3	1	3	1
Msc	-	-	-	-
<b>Në total</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>1</b>

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

GVJ vlerëson listën<sup>24</sup> e marrëveshjeve me institucione / organizata / shkolla të ndryshme për zhvillimin e praktikës mësimore dhe gjithashtu merr në konsideratë edhe deklarin e NjB në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për angazhimin e 6 anëtarëve të stafit në koordinimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale por në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL mungon një evidencë konkrete mbi këtë angazhim. Gjithashtu, GVJ vëren që në tabelat përmbledhëse (Evidence Aneks Tabelat Përmbledhëse ne MP Arsime Special) numri i personelit ndihmës akademik është 0.  
*Për sa më sipër, GVJ rekomandon evidentimin e mëtijshëm të angazhimit të personelit ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.*


<sup>24</sup> Evidenca 22. Lista e Marrëveshjeve

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacion e paraqitur<sup>25</sup> nga IAL, nuk arrin të vërtetojë plotësimin e këtij kriteri që i referohet koordinatorit të programit të studimit, në këtë rast koordinatorit të Masterit Profesional në “Arsim Special” ndërkohë që evidenca e paraqitur dhe që RVB i referohet është në fakt Vendimi nr. 26 i Rektorit për caktimin e koordinatorit të departamentit.</p> <p>Për sa më sipër, GVJ, është në pamundësi të verifikimit faktik të plotësimit të këtij kriteri.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, vëren se IAL, për kriterin 2 nuk ka bërë mjaftueshëm në lidhje me evidentimin e angazhimit të personelit ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike dhe gjithashtu për kriterin 3 nuk ka paraqitur evidencë të caktimit të koordinatorit të programit të studimit. Për këtë arsye GVJ gjendet në pamundësi të vlerësimit të plotë të standardit II.2 për shkak të mungesës së disa prej evidencave. Stafi akademik i departamentit mbulohet nga një numër më i vogël personeli.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<b>X</b>		

<p><b>Standardi II.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën</p>	<p>GVJ, bazuar në intervistat e kryera dhe bashkëbisedimet me përfaqësuesit e IAL, konfirmon që njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ vlerëson faktin që si statute ashtu edhe rregullorja e IAL janë të publikuara në faqen zyrtare të IAL<sup>26</sup></p>

<sup>25</sup> Evidenca 47. Urdher i brendshëm Nr 29 Emërim i Koordinatorës

<sup>26</sup> <https://umb.edu.al/upload/dossier/Statuti-UniBa-2020.pdf> dhe <https://umb.edu.al/upload/dossier/Rregullore-e-UniBa-Nr-7-date-28-03-2023.pdf>



dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për më tepër, informacionet e nevojshme mbi programin e studimit MPAS gjenden edhe online <sup>27</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në evidencat në dispozicion <sup>28</sup> , GVJ konfirmon që plani mësimor përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestër, ngarkesën mësimore të lëndëve /moduleve, dhe orët në auditor/jashtë auditorit.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ vëren që informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të publikuara në faqen online <sup>29</sup> të IAL si dhe në evidencat e paraqitura. <sup>30</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ, duke marrë në konsideratë evidencat e paraqitura <sup>31</sup> vëren përputhshmërinë me standardet e miratuara sipas bazës ligjore të formëzuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.03.2021.
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është	Nga bashkëbisedimi me njësinë bazë GVJ vuri re gatishmërinë dhe vullnetin për përditësimin e programit të studimit - hap i cili

<sup>27</sup> <https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-ne-arsim-special.html>

<sup>28</sup> Evidenca 3 “Rregullore e programit MPAS” dhe evidenca 2.1.b “Plani mësimor”

<sup>29</sup> <https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-ne-arsim-special.html>

<sup>30</sup> Evidenca 20.6 Vendimet për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve, Evidenca 18. Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i studentëve, dhe Evidenca 19. Rregullore e Brendshme për Transferimet\_Update në 2023.

<sup>31</sup> Evidence 2.6 “programet lëndore”

në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	parashikohet edhe në rregulloren e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional <sup>32</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	Konkretisht, njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, plani mësimor përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestër, ngarkesën mësimore të lëndëve /moduleve, dhe orët në auditor/jashtë auditorit, informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të publikuara në faqen online të IAL, programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore dhe program i studimit nuk ka pasur nevojë për përditësime në pritje të akreditimit të parë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</b>	GVJ vlerëson se ky program studimi ka pasur në fokus, që në fillesat e tij, punësimin në një fushë mjaft konkrete siç është arsimit special. Në këtë funksion është ndërtuar programi, kurrikula dhe shpërndarja lëndore. Studenti, në përfundim të këtij program studimi, ka përvetësuar njohuri të thelluara akademike dhe shprehi praktike në kuadrin e formimit si mësues ndihmës që në fokusin e punës së tyre kanë edukimin, zhvillimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Objektivi kryesor i programit të studimit është që studentët të fitojnë dije shkencore dhe pedagogjike të qëndrueshme në lidhje me integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në procesin e edukimit dhe promovimin e zhvillimit të tyre psiko-

<sup>32</sup> Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional

	social. Në këtë funksion janë përcaktuar edhe emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave <sup>33</sup> .																		
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ e konsideron të drejtë shpërndarjen në vite e semestra të lëndëve / moduleve dhe vlerësimin në kredite e orë mësimore. Kjo krijon premisat për të mundur arritjen e objektivave formues të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të kërkimit shkencor<sup>34</sup>. GVJ e gjen këtë shpërndarje në përputhje me përcaktimet e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021. Shpërndarja e lëndëve sipas komponentëve mësimorë përmbledhet në tabelën në vijim:</p> <table border="1" data-bbox="544 891 1385 1227"> <thead> <tr> <th data-bbox="544 891 1002 1016">Veprimtaria mësimore</th> <th data-bbox="1002 891 1190 1016">Kredite gjithsej</th> <th data-bbox="1190 891 1385 1016">Në raport ndaj totalit (120)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="544 1016 1002 1061">Lëndë bazë</td> <td data-bbox="1002 1016 1190 1061">12</td> <td data-bbox="1190 1016 1385 1061">10%</td> </tr> <tr> <td data-bbox="544 1061 1002 1106">Lëndë karakterizuese</td> <td data-bbox="1002 1061 1190 1106">48</td> <td data-bbox="1190 1061 1385 1106">40%</td> </tr> <tr> <td data-bbox="544 1106 1002 1151">Lëndë ndërdisiplinore /integruese</td> <td data-bbox="1002 1106 1190 1151">24</td> <td data-bbox="1190 1106 1385 1151">20%</td> </tr> <tr> <td data-bbox="544 1151 1002 1196">Lëndë plotësuese</td> <td data-bbox="1002 1151 1190 1196">12</td> <td data-bbox="1190 1151 1385 1196">10%</td> </tr> <tr> <td data-bbox="544 1196 1002 1227">Detyrime përmbledhëse</td> <td data-bbox="1002 1196 1190 1227">24</td> <td data-bbox="1190 1196 1385 1227">20%</td> </tr> </tbody> </table>	Veprimtaria mësimore	Kredite gjithsej	Në raport ndaj totalit (120)	Lëndë bazë	12	10%	Lëndë karakterizuese	48	40%	Lëndë ndërdisiplinore /integruese	24	20%	Lëndë plotësuese	12	10%	Detyrime përmbledhëse	24	20%
Veprimtaria mësimore	Kredite gjithsej	Në raport ndaj totalit (120)																	
Lëndë bazë	12	10%																	
Lëndë karakterizuese	48	40%																	
Lëndë ndërdisiplinore /integruese	24	20%																	
Lëndë plotësuese	12	10%																	
Detyrime përmbledhëse	24	20%																	
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi,</p>	<p>GVJ, nisur nga përvoja dhe nga bashkëbisedimi me stafin, vlerëson që struktura e programit, lëndët, raporti teori / praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. GVJ vlerëson gjithashtu që nga analiza e përmbajtjes lëndore ky program studimi ofron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional<sup>35</sup>.</p>																		

<sup>33</sup> Evidenca 1.1.a Mendimi i Dekanit, Evidenca 2.1 b. Plani mesimor, Evidenca 2.5 Programi per provimin e diplomim ne MPAS, Evidenca 2.6 Programe lendore-Sylabuse, Evidenca 4 Analiza e tregut te punes, Evidence Aneks Tabelat Permbledhese ne MP Arsim Special

<sup>34</sup> Evidenca "Aneks Tabelat përmbledhëse në MP Arsim Special"

<sup>35</sup> Evidenca 2.1.a Tabela e planit mësimor , Evidenca 2.1 b. Plani mësimor, Evidenca 2.6 Programe lëndore-Sylabuse)



kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ, referuar përcaktimeve të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar, vlerëson se ky program studimi ka ruajtur raportet e kërkuara mes veprimtarive formuese teorike dhe atyre praktike duke mbajtur një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike <sup>36</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ e konsideron të domosdoshëm shqyrtimin periodik të syllabuseve dhe të literaturës së lëndëve. Nisur nga bashkëbisedimi me stafin akademik të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, u evidentua që përditësimi i literaturës bëhet gradualisht me qëllim për të ruajtur balancat e nevojshme mes literaturës në gjuhën shqipe dhe asaj në gjuhë të huaj. Por, GVJ vëren që megjithëse literatura bazë është kryesisht e 5 viteve të fundit, literatura ndihmëse ka nevojë të përditësohet. <i>Për këtë arsye GVJ rekomandon që DSHETP të përshpejtojë punën për përditësimin e literaturës dhe të analizojë nevojën e përditësimit të syllabus-eve<sup>37</sup>.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ e vërejtë se ky program mbështet dhe mundëson një formim tërësor të studentëve për të zbatuar në mënyrë efektive "Komizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar" të Shqipërisë nga ana e mësuesve të arsimit special. MPAS synon që studentët të fitojnë kompetencat e duhura, profesionale të planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës, bazuar në kompetencat kyçe evropiane, të teorive dhe praktikave më të mira të mësimdhënies dhe të të nxënies, të metodologjive ndërvepruese dhe atyre të nxitjes së të menduarit kritik, por dhe njohje të thelluar të veçorive psikologjike të fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore. Metodologjia e vlerësimit gjithashtu ka një funksion thelbësor në këtë kontekst pasi ecurinë e procesit të të nxënies <sup>38</sup> .
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit	Programi i studimit Master Profesional në "Arsim Special" ofron një formim të ekuilibruar teoriko- praktik rreth trajtimit dhe

<sup>36</sup> Evidenca "Aneks Tabelat përmbledhëse në MP Arsimit Special"

<sup>37</sup> Evidenca 2.6 Programe lëndore-Syllabuse

<sup>38</sup> Evidenca 2.6 Programe lëndore-Syllabuse

mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	zhvillimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Duke qenë master profesional ky program studimi nuk mundëson vijim e studimeve akademike për titullin doktor por të diplomuarit në këtë program studimi mund të punësohen si mësues të të gjithë profileve në kopshte, shkolla të arsimit bazë dhe të mesëm në institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore të arsimit, etj <sup>39</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ rekomandon që DShETP të përshpejtojë punën për përditësimin e literaturës dhe të analizojë nevojën e përditësimin të syllabus-eve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpunje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ, bazuar në në rregulloren e departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional <sup>40</sup> , duke vlerësuar Studimin e tregut <sup>41</sup> si dhe nisur nga veprimtaria e Bordit të Karrierës që vepron pranë DShETP, vlerëson vullnetin për përmirësimin dhe përditësimin e këtij program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	GVJ, duke marrë në konsideratë rezultatet e bashkëbisedimit me studentët e MPAS si dhe angazhimin e studentëve në procesin e

<sup>39</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS dhe Evidenca 4 Analiza e tregut të punës

<sup>40</sup> Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional

<sup>41</sup> Evidenca nr. 4 "Analiza e tregut të punës"

tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	vlerësimit të procesit mësimor dhe të programit të lëndës <sup>42</sup> konkludon që si DShETP ashtu edhe IAL në përgjithësi ndjekin politika të hapura të nxitjes së pjesëmarrjes aktive të studentëve dhe strukturave të tyre me synimin për përmirësimin e programit të studimit dhe për një qasje sa më gjithëpërfshirëse të aktorëve të interesuar.			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ duke marrë në konsideratë feedback-un e marrë gjatë bashkëbisedimit me stafin akademik të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional vlerëson se bëhen përpjekje për shkëmbime mendimesh dhe eksperiencash me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra dhe institucione publike e private. Por nuk ka një evidentim të këtyre shkëmbimeve në formë të dokumentuar. <i>GVJ rekomandon që DSHETP të evidentojë dhe të nxisë më tej shkëmbimet me aktorë të interesuar me qëllim përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen nëse është e nevojshme të programit të studimit.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ, rekomandon që DSHETP dhe strukturat e përcaktuara të IAL të nxisin më tej shkëmbimet me aktorë të interesuar me qëllim përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen nëse është e nevojshme të programit të studimit dhe të evidentojnë në mënyrë të mjaftueshme këto shkëmbime.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të	GVJ konstaton që program i studimit Master Profesional në Arsim Special i ka të përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor dhe që janë në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Objektivat e programit të studimit master

<sup>42</sup> Evidenca 20.4. Formular vlerësimi i studenteve për lëndën, evidencë nr. 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit Sem I dhe Evidenca nr. 16.8. Raport mbi vlerësimin e studenteve për lëndën sem II



<p>studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>profesional në arsim special përqendrohen në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të nevojshme për t'u angazhuar në praktikën e edukimit për individë me nevoja të veçanta. GVJ vëren që këto program studimi synon:</p> <p><b>Zhvillimi i Aftësive Pedagogjike:</b> Të përgatisë profesionistë që të jenë të aftë për të krijuar dhe zbatuar metoda efektive të mësimdhënies për nxënësit me nevoja speciale.</p> <p><b>Njohja e Nevojave të Nxënësve:</b> Të zhvillojë kompetenca për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve dhe për të krijuar plane mësimore që i përmbushin ato.</p> <p><b>Integrimi dhe përfshirja:</b> Të promovojë praktikën e përfshirjes në klasë dhe të sigurojë që nxënësit me nevoja speciale të kenë akses të barabartë në arsim.</p> <p><b>Kultura dhe Sensibilizimi:</b> Të rrisë ndjeshmërinë dhe njohuritë për diversitetin kulturor dhe rolin e tij rëndësishëm në arsimimin e individëve me nevoja speciale.</p> <p><b>Ndihma dhe Bashkëpunimi:</b> Të zhvillojë aftësi për të punuar së bashku me profesionistët e tjerë, prindërit dhe komunitetin për të mbështetur nxënësit me nevoja speciale.</p> <p><b>Kërkimi shkencor në Edukimin Special:</b> Të inkurajojë hulumtimin dhe inovacionin në fushën e edukimit special për të kontribuar në zhvillimin e politikave dhe praktikave më të mira.</p> <p><b>Zhvillimi Profesional:</b> Të ofrojë mundësi për vazhdimin e zhvillimit profesional dhe përmirësimin e praktikave arsimore<sup>43</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit</p>	<p>GVJ vlerëson që, bazuar në Statutin e IAL dhe në Strategjinë e Thellimit Institucional 2020-2030, Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në rolin e njësive bazë, është përgjegjëse për nxitjen dhe koordinimin e veprimtarisë së mësimdhënies dhe asaj kërkimore. Po kështu NJSBC shtjellon hap pas hapi në dokumentin e përgatitur se si garantohet liria akademike<sup>44</sup>.</p>

<sup>43</sup> Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti, Evidenca 2.6 Programe lëndore-Sylabuse, Evidenca 3 Rregullore e programit të studimit

<sup>44</sup> Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit Barleti, Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, Evidenca 6 Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike dhe financiare, Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 - 2030 (përditësuar janar 2024)



akademik dhe fushën e veçantë të studimit.									
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	GVJ vlerëson se IAL, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të klubeve studentore, trajnimeve, leksioneve të hapura, konferencave studentore dhe mobilitetit nëpërmjet Erasmus +, ka krijuar premisa mjaft pozitive për pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete, projekte dhe studime <sup>45</sup> .								
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	GVJ vëren se stafi akademik i DShETP është anagzhuar intensivisht në aktivitete studimore, kërkimore e shkencore <sup>46</sup> . Gjithashtu nga hulumtimi i evidencës financiare <sup>47</sup> të paraqitur, paraqitet qartësisht se ç’pjesë të financimit këto aktivitete e marrin nga IAL për realizimin e kërkimit shkencor dhe projekteve.								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ, bazuar në nivelin e plotësisht të kriterëve individuale të këtij standardi dhe evidencave të paraqitura, vlerëson se ky program studimi garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor duke qenë se ky program i studimit i ka të përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor, departamenti nxit dhe koordinon veprimtarinë e mësimdhënies dhe asaj kërkimore, pjesëmarrja e studentëve në aktivitete, projekte dhe studime nxitet nëpërmjet klubeve studentore, trajnimeve, leksioneve të hapura, konferencave studentore dhe mobilitetit Erasmus +, dhe se stafi akademik i DShETP është angazhuar plotësisht në aktivitete studimore, kërkimore e shkencore.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>45</sup> Evidenca 20.2. Strategjia e klubeve studentore 2020-2025, Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve, Evidenca 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +, Evidenca 32.d. botimet UNIBA

<sup>46</sup> Evidenca 26.1 Raporti Kerkimit Shkencor 22-23

<sup>47</sup> Evidence 40.a Burimet Financiare



<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ konfirmon se IAL, nëpërmjet institutive dhe organizatave jo-fitimprurese të themeluara nga institucioni, mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. Në këtë kuadër funksionon edhe Qendra e Kërkimit dhe Novacionit për Zhvillim dhe Sipërmarrje (BRIDGE) që është një nismë e Universitetit Barleti<sup>48</sup> që ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin, i cili së bashku me novacionin dhe transferimin e teknologjive vlerësohen si faktorë themelorë për një ekonomi të orientuar nga dijet<sup>49</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ vlerëson se IAL Barleti angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në projekte dhe studime me karakter kërkimor dhe shkencor. Për më tepër kërkimi shkencor në këtë IAL zhvillon komponentët e tij si kërkimin bazë e të aplikuar nëpërmjet një strukture bashkëkohore, ku njësitë organizative janë të organizuara në mbështetje të fushave kërkimore<sup>50</sup> prioritare dhe të novacionit<sup>51</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ thekson që, bazuar në bashkëbisedimet e kryera dhe në evidencën e paraqitur<sup>52</sup>, njësia përgjegjëse organizon konferenca dhe aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ është i mendimit që ky program studimi ofron një paketë të plotë të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Si e tillë kjo paketë dijet ka potencialin që të formëzojë profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Por, GVJ nuk është në gjendje të vlerësojë sa kjo arrihet në</p>

<sup>48</sup> <https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-UniBa.html>

<sup>49</sup> Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 - 2030 (përditësuar janar 2024) dhe Evidenca 10.1. Strategjia e nderkombetarizimit

<sup>50</sup> <https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-UniBa.html>

<sup>51</sup> Evidenca 10. Strategjia e zhvillimit institucional 2020 - 2030 (përditësuar janar 2024) dhe Evidenca 10.1. Strategjia e nderkombetarizimit

<sup>52</sup> Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve



	realitet dhe të dhënat statistikore <sup>53</sup> të zyrës së karrierës dhe alumni nuk kanë një ndarje sipas profileve të studimit.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	GVJ vlerëson se DSHETP, ka bërë një hap të rëndësishëm në plotësimin e këtij kriteri me ngritjen e Bordit të Karrierës, qëllimi i të cilit është përmirësimi i kurrikulave dhe programeve në funksion të integritimit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës <sup>54</sup> . Ky bord luan një rol domethënës për punësimin e studentëve të fushës së edukimit, që më pas punësohen në institucionet arsimore parauniversitare, në organizma lokale e qendrorë të arsimit, si dhe në institucione të tjera të shoqërisë civile <sup>55</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	GVJ, bazuar në ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ku profesioni i mësuesit përfshihet në profesionet e rregulluara, vlerëson se ky program studimi përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe u jep mundësinë studentëve të diplomuar të futen në provimin e licencimit duke qenë master profesional në fushën e mësuesisë.
<b>Konkluzione</b>	<i>IAL nëpërmjet instituteve dhe organizatave jo-fitimprurëse të themeluara nga institucioni, mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare, departamenti dhe stafi akademik angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në projekte dhe studime me karakter kërkimor dhe shkencor, organizon konferenca dhe aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave, synon të angazhojë Bordin e Karrierës në përmirësimin e kurrikulave dhe programeve në funksion të integritimit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës, duke ofruar kështu në tërësi potencialin që të formëzojë profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Gjithashtu, ky program studimi përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe u</i>

<sup>53</sup> <https://umb.edu.al/upload/pdf/Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf>

<sup>54</sup> <https://umb.edu.al/news/1166.html>

<sup>55</sup> Evidenca 28 Bordi karrieres.pdf

	<i>jep mundësinë studentëve të diplomuar të futen në provimin e licencimit duke qenë master profesional në fushën e mësuesisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ vëren që mësimdhënia në këtë program studimi kryhet në kombinim dhe në raportet e dhura mes leksioneve, seminareve, punë laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike dhe orët e hapura <sup>56</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra,	GVJ, bazuar në bisedat e kryera me stafin akademik dhe me studentë si dhe në bazë të vlerësimeve të studentëve <sup>57</sup> vëren se personeli akademik i përgjigjet më së miri kërkesave dhe pritshmërive të studentëve. Po kështu, duke marrë në konsideratë

<sup>56</sup> Evidenca 2.1 b. Plani mesimor, Evidenca 2.1.a Tabela e Planit mesimor ng A- E, Evidenca 2.6 Programe lendore-Sylabuse

<sup>57</sup> Evidenca 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit\_Sem dhe Evidenca 16.8. Raport me vlersimin e studenteve per lenden sem II

<p>metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>dokumentacionin<sup>58</sup> e vënë në dispozicion vihet re që personeli akademik ofron forma dhe metoda mësimdhënëse që garantojnë përfshirjen aktive të studentëve nëpërmjet shpjegimit në klasë, punës së pavarur, prezantimeve, studimeve të rastit, diskutimeve dhe debateve, feedback-ut, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Siç ka evidentuar edhe më sipër, GVJ, konfirmon që IAL vlerëson dhe mbështet rritjen akademike të stafit nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së stafit në aktivitete shkencore dhe ofrimit të mjeteve të nevojshme, edhe financiare. Evidencat e paraqitura<sup>59</sup> mbështesin këtë gjetje të GVJ. Një metodë që nxit ndërveprimin dhe përmirësimin e personelit akademik është edhe bashkëpunimi nëpërmjet vlerësimit të mësimdhënies kolegjë me kolegjë<sup>60</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ vlerëson që stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi<sup>61</sup>, plotëson të gjitha kriteret e kompetencës dhe njohurive për angazhim në mësimdhënie. Po kështu, vlerësimi i studentëve është mjaft i mirë<sup>62</sup>. Metodologjia e përdorur evidentohet në dokumentacionin<sup>63</sup> e dhënë dhe përfshin format dhe metodat kryesore që aktualisht përdoren gjërisht në mësimdhënie si shpjegimi në klasë, puna e pavarur, prezantimet, studimet e rastit, diskutimet dhe debatet, feedback-u, etj.</p>

<sup>58</sup> Evidencën 2.6 “Programe lëndore-Syllabuse”

<sup>59</sup> Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve, Evidenca 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +, Evidenca 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +, Evidenca 40.a Burimet Financiare

<sup>60</sup> Evidenca 16.5 Formular i vlerësimit kolegjë me kolegjë Peer Evaluation of Teaching

<sup>61</sup> Evidence 7.2 “CV e stafit”

<sup>62</sup> Evidenca 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit\_Sem dhe 16.8. Raport me vlersimin e studenteve per lenden sem II

<sup>63</sup> Evidence 2.6 Programe lëndore-Sylabuse



<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin – evidencat e poshtë-shënuara, vlerëson se IAL ka ngritur një sistem të mirëorganizuar të vlerësimit të procesit të mësimdhënies dhe kryen kontrollin e cilësisë në mënyrë periodike. Ky sistem<sup>64</sup> ofron një qasje gjithëpërfshirëse duke angazhuar studentët dhe stafin akademik për të dhënë një vlerësim sa më objektiv mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimin dhe përmbytjen e lëndës</li> <li>• Materialet didaktike</li> <li>• Vlerësimin</li> <li>• Aftësitë e pedagogut.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>GVJ vlerëson që IAL, nëpërmjet Njësise së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë<sup>65</sup>, nxit dhe promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinimin dhe bashkërendimin me njësitë kryesore/bazë të aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Për më tepër IAL ka zhvilluar edhe një Udhëzues për metodat e mësimdhënies <sup>66</sup>dhe nxit dhe mbështet në vijimësi stafin akademik për të marrë pjesë në trajnime apo aktivitete kërkimore-shkencore<sup>67</sup>.</p>

<sup>64</sup> Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies, Evidenca 16. Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit, Evidenca 16.3. Formular-Raportim i Punës Semestrare të pedagogut, Evidenca 16.4. Formulari i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentet, 16.5 Formulari i vlerësimit kolege me kolege, Evidenca 16.6. Formulari për transparencë të vlerësimit, Evidenca 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit Sem I, Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studenteve për lëndën sem II

<sup>65</sup> Evidenca 16.2. Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>66</sup> Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies

<sup>67</sup> Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve.

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ, duke marrë parasysh që</i> mësimdhënia në këtë program studimi kryhet në kombinim dhe në raportet e duhura mes leksioneve, seminareve, punë laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike dhe orët e hapura, se personeli akademik i përgjigjet më së miri kërkesave dhe pritshmërive të studentëve. Po kështu, duke marrë në konsideratë dokumentacionin <sup>68</sup> vihet re që personeli akademik ofron forma dhe metoda mësimdhënëse që garantojnë përfshirjen aktive të studentëve nëpërmjet shpjegimit në klasë, punës së pavarur, prezantimeve, studimeve të rastit, diskutimeve dhe debateve, feedback-ut, se IAL vlerëson dhe mbështet rritjen akademike të stafit nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së stafit në aktivitete shkencore, se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, plotëson të gjitha kriteret e kompetencës dhe njohurive për angazhim në mësimdhënie, si dhe faktin që IAL ka ngritur një sistem të mirëorganizuar të vlerësimit të procesit të mësimdhënies dhe kryen kontrollin e cilësisë në mënyrë periodike duke nxitur dhe promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinimin dhe bashkërendimin me njësitë kryesore/bazë të aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies <i>vlerëson se të gjithë kriteret e këtij standardi plotësohen tërësisht.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi III.2</b> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të	GVJ vëren se rregullorja e programit të studimit MPAS <sup>69</sup> përcakton qartë në nenin 17 dhe vijues, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit. Por nga kërkimi në faqen WEB të institucionit nuk rezulton që kjo rregullore të jetë e publikuar. GVJ gjithashtu thekson se Evidenca nr.13 (Rregullore për testimet, provimet, kriteret për procedurat e diplomimit) që RVB i referohet mungon tërësisht.

<sup>68</sup> Evidencë 2.6 "Programe lëndore-Syllabuse"

<sup>69</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS





posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<i>GVJ rekomandon bërjen publike të kriterëve dhe mënyrave të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore.</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve/moduleve kanë të specifikuar edhe metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore <sup>70</sup> dhe nga bashkëbisedimi me stafin akademik konfirmohet që në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen mbi këtë, ashtu si edhe parashikohet në rregulloren e programit të studimit <sup>71</sup> . GVJ vëren gjithashtu se RVB sërish i referohet një evidence që nuk ekziston, konkretisht <i>Evidenca nr. 44 Procedura për monitorimin e fillimit të procesit mësimor.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konfirmon, duke u bazuar në rregulloren e programit të studimit MPAS <sup>72</sup> , që testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, si provimi me shkrim, me gojë ose i kombinuar, me ese, detyra kursi, projekte, postera, aktivizimi në klasë, provimet e ndërmjetme, etj. ( <i>shih neni 17 mbi kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit.</i> )			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ rekomandon bërjen publike të kriterëve dhe mënyrave të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Gjithashtu GVJ thekson mungesën në referencat e dhëna në RVB.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>70</sup> Evidence 2.6 Programe lëndore-Sylabuse

<sup>71</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPAS

<sup>72</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ, bazuar në rregulloren e programit të studimit<sup>73</sup> dhe në syllabuset e paraqitura<sup>74</sup>, vlerëson se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet bazuar në provimin përfundimtar (50%), provimet e ndërmjetme, pjesëmarrja dhe aktivizimi në klasë, detyrat e kursit, etj<sup>75</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ, duke marrë në shqyrtim evidencat e paraqitura dhe bashkëbisedimet me stafin akademik dhe studentët e MPAS, vlerëson se IAL vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën<sup>76</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e paraqitur<sup>77</sup>, duke marrë në konsideratë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Testimet vlerësohen nga pedagogu i lëndës sipas një strukture të mirëpërcaktuar;</li> <li>- Testi miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit;</li> <li>- Fleta e vlerësimit miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe nga Kryesekretari;</li> <li>- Studenti ka të drejtën e ankimit;</li> <li>- Komisioni i ri-vlerësimit, i ngritur nga dekani, është përfundimtar.</li> </ul> <p>Vlerëson se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Nisur nga bisedat me stafin akademik dhe studentët si dhe nga evidencat e dokumentuara<sup>78</sup>, GVJ shprehet se ky kriter plotësohet duke qenë se IAL ka në fokus përmirësimin e procesit të</p>

<sup>73</sup> Evidenca nr. 3 “Rregullore e programit të studimit MPAS”

<sup>74</sup> Evidenca 2.6 Programe lendore-Sylabuse

<sup>75</sup> Evidenca 2.6. a Teza e provimit ndërmjetëm dhe Evidenca 2.6. a Teza e provimit përfundimtar

<sup>76</sup> Evidenca 16.6. Formulari për transparencë të vlerësimit

Evidenca 29. GUIDE instruktive e mesimit On-line, Evidenca 29. a Manual i mesimdhënie online, Evidenca 38.

Manual perdorimi i Google Classroom per pedagoget, Evidenca 38.h. Udhezues per provimet ne Google Forms

Evidenca 38.g. Manuali\_Google\_Classroom\_Pedagogu

<sup>77</sup> Evidencë nr. 3 “Rregullore e programit të studimit MPAS”

<sup>78</sup> Evidenca 2.6. a Teza e provimit ndërmjetëm dhe Evidenca 2.6. a Teza e provimit përfundimtar

shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	mësimnxënies dhe këtë e realizon edhe nëpërmjet komentimit dhe këshillimit të studentit gjatë gjithë vitit.
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ vlerëson se rregulloret respektive të IAL dhe DSHETP <sup>79</sup> shprehin qartësisht politikat e institucionit për të parandaluar dhe shamnur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra.
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ vlerëson se rregullorja <sup>80</sup> relevante e IAL, konkretisht nenet 85 e vijues, synojnë të garantojnë që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë. Në nenin 91 të kësaj rregulloreje përcaktohet edhe afati 7 ditor I dorëzimit të fletës së vlerësimit nga pedagogu I lëndës në sekretarinë mësimore.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ vlerëson në bazë të evidencave shkresore <sup>81</sup> dhe bashkëbisedimeve të kryera se e drejta e studentit për tu njohur me vlerësimin dhe eventualisht për të kërkuar rishikimin e tij, është shprehur qartësisht.
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	GVJ vlerëson, bazuar në evidencën <sup>82</sup> e dhënë, se studentit i sanksionohet e drejta e ankesës me shkrim për notën në modulim/lëndën në afat prej dy (2) ditësh nga data e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës, por para shënimit të notës në Regjistrin e arritjeve akademike. Ankesa i drejtohet Dekanit, i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar dhe

<sup>79</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e UniBa dhe Evidenca 1.3 Rreg. Dept. Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional

<sup>80</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e UniBa

<sup>81</sup> Evidenca 3: Rregullore e studimeve për programin MPAS.

<sup>82</sup> ibid

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet e arkivohet në sekretarinë mësimore.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se IAL siguron një vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritë, dhe i njeh studentit të drejtën e ankimit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ vlerëson, bazuar në diskutimet me stafin akademik dhe atë studentor, si dhe në evidencat e paraqitura <sup>83</sup> në lidhje me syllabuset lëndore, stafin akademik të angazhuar, bashkëpunimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, etj që ky program studimi shpreh synime të qarta të përgatitjes së studentëve dhe zhvillimit të aftësive profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ vlerëson se procesi i mësimdhënies me në qendër studentin dhe ndërveprimin pedagogjik, së bashku me përdorimin intensiv të teknologjisë së informacionit (video-projektor, internet, manualët dhe guidat për mësimdhënien online, etj.) garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit <sup>84</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo	GVJ, bazuar në evidencën verbale dhe atë shkresore <sup>85</sup> , konstaton që në analizën e punës së departamentit shqyrtohet edhe niveli i

<sup>83</sup> Evidenca 2.1 b. Plani mesimor, Evidenca 2.1 a Tabela e Planit mesimor ng A- E, Evidenca 2.3 Paketa e praktikës, Evidenca 2.6 Programe lëndore-Syllabuse, Evidenca 7.2 CV e stafit, Evidenca 22. Lista e Marreveshjeve, Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve

<sup>84</sup> Evidenca 29.a. Manual i mësimdhënies On-line, Evidenca 38. Manuali i përdorimit të Google Classroom për pedagogjet, Evidenca 38.b. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentet, Evidenca 38.c. Manuali i përdorimit të GSuit, Evidenca 38.a. Udhezues për përdorimin e Struktura të Teknologjisë së Informacionit, Evidenca 29. Guide instruktive e mesimit On-line

<sup>85</sup> Evidenca 16.3. Formular-Raportim i Punës Semestrale të pedagogut, Evidenca 16.4. Formular i vlerësimit të lëndës dhe pedagogut nga studentet, Evidenca 16.5 Formular i vlerësimit kolege me kolege Peer Evaluation of Teaching, Evidenca 16.7. Raport mbi rezultatet e formularit të studentit Sem I, Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studenteve për lëndën sem II

<p>lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve, sfidat e hasura, efektiviteti i metodave të mësimdhënies, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve, etj. Gjithashtu, të gjithë studentët e intervistuar konfirmuan që pedagogët e lëndëve, në përfundim të lëndëve bëjnë një përmbledhje të temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre në praktikë por edhe si përgatitje për provimin e lëndës duke konsoliduar kështu tek studentët njohuritë thelbësore të trajtuara.</p> <p><i>GVJ vëren edhe në lidhje me këtë kriter që RVB i referohet një evidence që nuk është dërguar nga institucioni (Evidenca 35: Raporti vjetor i departamentit).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ, pasi shqyrtoi elementët përbërës të programit të studimit, vlerëson se mësimdhënia zhvillohet në bazë të kompetencave të përgjithshme dhe specifike, sipas karakterizimit të lëndëve. Qëllimi është t'u ofrojë studentëve mundësinë për të thelluar njohuritë dhe oër ti zhvilluar ato në laboratorë dhe në praktikën profesionale. Gjithashtu, programi i studimit, nëpërmjet bashkëpunimeve të ndryshme, i ofron mundësi praktike studentëve për të thelluar dhe aplikuar njohuritë në kontekstin praktik. Stafit akademik, siç tregohet edhe në syllabuset e lëndëve, jep mbështetje të theksuar për zhvillimin e mendimit kritik, diskutimeve dhe punës në grup. Ai krijon një atmosferë të përshtatshme për nxitjen e ideve inovative, promovon studimet kërkimore-shkencore dhe integron format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese, me qëllim të mundësimit dhe rritjes së mobilitetit të studentëve<sup>86</sup>.</p> <p><i>GVJ edhe në këtë rast vëren që RVB i referohet dy evidencave të padërguara (Evidenca 32.f. Lista e konkurseve ne mbështetje te sipermanjeve rinore dhe Evidenca 32.e. Projekte te zbatuara dhe ne proces Grupi Barleti).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të</p>	<p>GVJ, gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe me studentët, por edhe nga verifikimi i faqes zyrtare të IAL, vëren se</p>

<sup>86</sup> Evidenca 2.3 Paketa e praktikës, Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS, Evidenca 10. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve, Evidenca 32.c. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +

<p>hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>IAL është mjaft aktiv në organizimin e aktiviteteve shkencore dhe leksioneve të hapura<sup>87</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>GVJ vlerëson se IAL ka krijuar një strukturë solide të mbështetjes së ideve bashkëkohore të studenteve dhe iu krijon mundësi për përfshirje në projekte kërkimore e studime të avancuara nëpërmjet instituteve<sup>88</sup> "UniBa". Por GVJ nuk gjen evidencë të mbështetjes financiare të këtyre projekteve.</p> <p><i>Gjithashtu GVJ eidenton që RVB i referohet serish evidencave që nuk ekzistojnë mes atyre të paraqitura (Evidenca 32.e. Projekte te zbatuara dhe ne proces Grupi Barleti, Evidenca 32.f.Lista e konkurseve ne mbeshtetje te sipermanjeve rinore)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, për sa u përshkrua më sipër, vëren se ky program studimi shpreh synime të qarta të përgatitjes së studentëve dhe zhvillimit të aftësive profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve, procesi i mësimdhënies ka në qendër studentin dhe ndërveprimin pedagogjik, ka një përdorimin intensiv të teknologjisë së informacionit, garantohet zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit, në analizën e punës së departamentit shqyrtohet edhe niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët, sfidat e hasura, efektiviteti i metodave të mësimdhënies, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve, në përfundim të lëndëve pedagogët e lëndës bëjnë një përmbledhje të temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre në praktikë por edhe si përgatitje për provimin e lëndës, IAL është mjaft aktiv në organizimin e aktiviteteve shkencore dhe leksioneve të hapura të mbështetjes së ideve bashkëkohore të studenteve dhe iu krijon mundësi për përfshirje në projekte kërkimore e studime të avancuara. Por, në mungesë të disa dokumentave të referuara nga RVB, GVJ konkludon që ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<sup>87</sup> Evidenca 32.a. Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve

<sup>88</sup> <https://fshsts.umb.edu.al/kerkimi-shkencor.html> dhe <https://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html>

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se për të fituar diplomën Master Profesional (120 ECTS) në Arsim Special studenti duhet të kalojë provën finale që bazuar në evidenca<sup>89</sup>, duhet që studentit të ketë siguruar të paktën 96 kredite dhe studimet përmbyllen me provën finale, në formën e provimit të përgjithshëm të formimit. Po kjo evidencë specifikon që “kërkesat dhe procedurat për provën finale përcaktohen në aktet rregullatore të brendshme”. Ndërkohë, GVJ konstaton që RVB referon edhe “një tezë kërkimi, një seri esesh, një projekt kërkimi, një dosje kërkimi” si mundësi të provës finale. Por GVJ nuk ka në dispozicion një akt rregullator të brendshëm që specifikon këto forma alternative.</p> <p>Gjithashtu, GVJ nuk arrin të konstatojë publikimin e procedurës për detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Për sa më sipër GVJ nuk është në pozitë për të verifikuar shkallën e plotësisht të kriterit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ vlerëson nga bashkëbisedimi me stafin akademik dhe me studentët që strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Po kështu, nga evidencat e paraqitura<sup>90</sup> GVJ vlerëson se njësia përgjegjëse ka krijuar tashmë një strukturë dhe proces të asistimit të studentëve.</p> <p><i>Por, GVJ vëren që evidenca 2.4: Fondi i pyetjeve provim formimi MPAS, referuar në RVB, mungon.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në</p>	<p>GVJ, marrë në shqyrtim evidencat e paraqitura vëren se studentët për të fituar diplomën e studimeve, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës profesionale, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale. Komisioni i Provës Finale i ngritur për vlerësimin e studentëve në provimin final të programit të studimit master profesional në Arsim Special bazohet në procedurat e përshkruara hollesisht<sup>91</sup>. GVJ gjithashtu vëren<sup>92</sup> se testimi final përmbledh njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit akademik dhe përfshin</p>

<sup>89</sup> Evidence 3: Rregullore e studimeve për programin MPAS

<sup>90</sup> Evidence 2.5 Programi për provimin e diplomimit në MPAS dhe Evidenca 2.6. a Teza e provimit përfundimtar

<sup>91</sup> Evidencë 3. Rregullore e programit MPMAS, Kreu III “Vlerësimi i Studentit”, nenet 16-21

<sup>92</sup> Evidencë 2.5 “Programi për provimin e diplomimit në MPAS”



bazë të rëndësishme dhe peshës specifike.	të gjitha lëndët. Për sa më sipër GVJ konkludon se procedura e provimit final është e mirëpërcaktuar.
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ vlerëson<sup>93</sup> që prova finale është vetëm në formën e provimit të përgjithshëm të formimit. Rrjedhimisht rezultoni që forma të tjera, të paparashikuara në rregulloren e programit të studimit, nuk janë të vlefshme.</p> <p>GVJ vëren deklarin e RVB <i>“Ne rastet kur kemi tezë diplome, pasi tezë kërkimi bëjnë ata studentë që kanë mesatare mbi 9,5 me vendim senati, këtyre studentëve i caktohet udhëheqësi nga stafi i departamentit dhe miratohet komisioni i diplomimit për mbrojtjen e tezës”</i>. Ky aspekt, në mendimin e GVJ kërkon një vlerësim më të hollësishëm të dokumentacionit / RVB.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ vëren që programi i studimit Master Profesional në Arsim Special, ndër të tjera parashikon edhe zhvillimin e lëndës <i>“Metoda të Kërkimit Shkencor”</i><sup>94</sup> ku jepen njohuri të thelluara të formulimit të pyetjeve kërkimore, strategjive të kërkimit, kampionimit, analizës së të dhënave sasiore dhe cilësore, etj. Gjithashtu GVJ vëren se në të gjitha lëndët e këtij programi studimi<sup>95</sup> zhvillohen punë të pavaruara dhe detyra kursi të karakterit kërkimor. Në këtë kontekst dhe bazuar edhe në intervistat e kryera me studentë dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, GVJ është i opinionit që ky kriter plotësohet.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton bazuar në evidenca<sup>96</sup> që studenti në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, vlerësohet me notë.</p>

<sup>93</sup> Evidencë nr. 3 Rregullore e studimeve për programin MPAS, neni 16

<sup>94</sup> Evidenca 2.6 Programe lëndore-Sylabuse

<sup>95</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

<sup>96</sup> ibid



<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ, bazuar në evidencat<sup>97</sup> referon që në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Me kërkesë, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që në arkivin e IAL ruhet një kopje e dokumentacionit të secilit student.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton që IAL ka një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit MP në Arsim Special dhe që IAL ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm të zhvillimit të procedurës, referuar evidencave të paraqitura. Por, GVJ konstaton mangësi në lidhje me evidencat e vëna në dispozicion ose të cilave i referohet RVB. GVJ gjithashtu vëren që RVB i referohet procedurave të diplomimit që nuk janë të specifikuar në rregulloren e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes sëstandardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi III.6</b> Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe</p>	<p>GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione publike dhe jopublike arsimore, me OJF dhe Qendra të zhvillimit të</p>

<sup>97</sup> Evidenca 3: Rregullore e studimeve për programin MPAS, konkretisht Kreu IV “Diplomimi” (neni 22 dhe 23)

<p>përfitim të njohurive, garantojnë mjedis brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>fëmijëve, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale. Siç evidentohet edhe nga evidencat e paraqitura<sup>98</sup>, ekziston një praktikë e konsoliduar e zhvillimit të praktikës profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Nga bashkëbisedimi me stafin drejtues të DSHETP, GVJ vlerëson që në funksion të garantimit të cilësisë së praktikës profesionale, një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përzgjedhjes së partneriteteve ku ofrohen disa nga format dhe metodologjitë më të mira në vendin tonë<sup>99</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>GVJ, bazuar në <i>evidenca</i><sup>100</sup>, konfirmon që praktikrat profesionale dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren e studimeve për programin MPAS<sup>101</sup>, praktika rezultojnë që vlerësohet dhe ekuivalentohet në kredite ashtu si edhe çdo aktivitet mësimor.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson që DShETP, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione publike dhe jopublike arsimore, me OJF dhe Qendra të zhvillimit të fëmijëve, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përzgjedhjes së partneriteteve me</i></p>

<sup>98</sup> Evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës, Evidenca 22: Lista e marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit

<sup>99</sup> Evidenca 22: Lista e manevrësive të partneritetit në funksion të programit të studimit

<sup>100</sup> evidenca 2.3 UniBa Paketa e praktikës

<sup>101</sup> evidencë nr. 3, Rregulloren e studimeve për programin MPAS



	<i>institucione ku ofrohen disa nga format dhe metodologjitë më të mira në vendin tonë. Zhvillimi I praktikës profesionale dokumentohet duke përfshirë mendimin e mentorëve / trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. Praktika profesionale vlerësohet dhe ekuivalentohet në kredite ashtu si edhe çdo aktivitet mësimor</i>			
<b>iShkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, gjykojmë se të dhënat e bazuara në CV-në <sup>102</sup> e stafit PAE/PAK të angazhuar në këtë program studimi, nuk janë të plota. Për vitin akademik 2022-2023, mungon CV-ja e një pedagogu efektiv (F.K.) dhe CV-ja e një pedagogu me kontratë (R.Ç), për vitin 2023-2024 nuk konfigurojnë me CV e tyre pedagogë efektiv (R.Ç, F.K., A.V., E.P). Vihet re se në vitin akademik 2023-2024 ka lëvizje të sfatit akademik efektiv, ku janë larguar tre punonjës (M.K., O.M., F.Sh.) të cilët janë zëvendësuar me një personel akademik me gradën Prof.As.Dr. (R.Ç), më parë staf me kohë të pjesshme, me dy pedagogë me gradën doktor shkencash dhe me një pedagog pa kualifikim. Edhe pse nga personeli akademik i punësuar gjatë vitit akademik 2023-2024, 3 prej tyre kanë titull dhe grada shkencore, sërish, largimi i 3 anëtarëve të larguar është mbi 30% e stafit efektiv, duke treguar një

<sup>102</sup> Evidenca 32. CV të stafit akademik

përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

paqëndrueshmëri në këtë staf<sup>103104</sup>. Një aspekt që duhet të konsiderohet me vëmendje lidhet me një pjesë të stafit akademik efektiv të cilët nuk i zotërojnë kualifikimet e të tre niveleve (BA, MA, DR) në fushën e edukimit special (O.M, gjuhë-letërsi, e më pas doktoraturë në sociologji; E.M. edukimin bazë në gazetari dhe më pas ka vazhduar ciklin e dytë të studimeve në marketing mediatik, A.R ka mbaruar studimet bazë për gjuhë-letërsi, e më pas ka avancuar në këtë drejtim), kualifikime të cilat mund të kenë mospërputhje me nevojat për njohuri që lidhen drejtpërsëdrejti me kurset e programit dhe me interesat studimore që shprehin studentët në fushat e edukimit special, duke mos qenë brenda fushës së tyre të kompetencës apo duke mos vazhduar të specifikohen në fushën e tyre të kompetencës. Gjithashtu, në CV për programin janë vënë edhe staf akademik i cili nuk figuron në listën e pedagogëve të programit e që kanë fusha të tjera studimi (R.K., Z.Ç, A.Gj.). Bazuar në tabelën e mëposhtme e cila ka përmbledhur të dhënat e marra nga lista e plotë e stafit akademik të programit, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë si për vitin 2022-2023 dhe për vitin 2023-2024 është mbi 70% në krahasim me personelin me kohë të pjesshme duke treguar një kapacitet të lartë të institucionit në nivel të stafit akademik efektiv të angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Edukim Special”.

Tituj/grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof.As.Dr.	1	-	2	-

<sup>103</sup> Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021. Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë

<sup>104</sup> Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021. Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë

	Dr/PhD	3	1	3	1
	Msc	-	-	-	-
	<b>Në total</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>1</b>

Vihet re se për vitin akademik 2022-2023, 77% e pedagogëve kanë qenë me gradë shkencore/tituj akademik, ndërsa 23% kanë qenë me Msc, nuk ka pasur staf akademik me titullin Prof.Dr., ndërsa me titullin Prof.As.Dr. kanë qenë 22% e stafit. Në vitin akademik 2023-2024 vërehet i njëjti trend për përqindjet e kualifikimeve të stafit akademik.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ identifikoi një problem serioz me punësimin e stafit akademik, ku u vu re se staf akademik me kohë të plotë, mbanin pozicione të stafit administrativ, si p.sh. përgjegjës i bibliotekës, përgjegjës i zyrës së projekteve, duke përfaqësuar në takimet institucionale dhe stafin por edhe rolin tjetër që ato kishin në pozicione në administratë. Në kontratat e punës<sup>105</sup> së tyre nuk specifikohet ky rol, por specifikohet se stafi akademik ka orë administrative. Ky rol si personel administrativ i stafit akademik duhet adresuar sa më shpejt pasi është shumë shqetësues në pengimin e tyre të zhvillimit profesional si akademik.

*GVJ duke u bazuar në të dhënat mbi stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi gjykon se dy çështje të cilat kanë nevojë të adresohen janë qëndrueshmëria e stafit, ruajtja e profileve akademike për stafin akademik sipas kurseve të ofruara në program, dhe garantimi i funksioneve të stafit akademik duke asistuar zhvillimin e tyre të karrierës akademike dhe jo pengimin e tyre duke mbajtur pozicione të plota si personel administrativ.*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Në tabelat 12 për planin mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës, për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024, ngarkesat mësimore mungojnë si për PAE dhe për PAK<sup>106</sup>. Këto tabela nuk janë të plota, pasi mungon ngarkesa e stafit akademik për programin studimor si dhe nuk janë përcaktuar stafi akademik PAE dhe PAK. Ndërkohë në listën e stafit akademik të

<sup>105</sup> Evidenca 7.4 Kontratë Pune Template

<sup>106</sup> Evidenca Aneks, Tabelat Përmbledhëse MP Arsim Special

	<p>DSHETP<sup>107</sup>, ka mospërputhje në emra të stafit, kontratave të tyre me tabelat 12. Në tabelën 4<sup>108</sup> për ngarkesën totale të personelit akademik të programit studimor rezultojnë vetëm për vitin 2023-2024 të dhëna për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK, por që konfiguror jo korrekte pasi një staf akademik PAK (A.ZH) konfiguror staf PAE. Gjatë vizitës, GVJ ka kërkuar një tabelë me të dhëna të plota sipas tabelave excel të ASCAL, për të dy vitet akademike duke përcaktuar korrektësisht stafin akademik PAE dhe PAK. Kjo evidencë nuk u dërgua, në mënyrë që të saktësoheshin të dhënat. Nga të dhënat aktuale për ngarkesën mësimore vjetore<sup>109</sup>, vihet re stafi i angazhuar në këtë program mbulon orë mësimore që variojnë nga minimumi 37 orë mësimore në auditor për lektorë, në maksimumin 240 orë në auditor për këtë program. Por, mungojnë evidenca për orët vjetore të këtyre pedagogëve që janë të angazhuar në këtë program studimor. Vihet re se për këtë program studimor, stafi është me 1 deri në 3 lëndë semestrale, por nuk kemi të dhëna për orët vjetore të stafit akademik të këtij programi në programe të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni nuk garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv, që janë pjesë e njësisë bazë. Lidhur me stafin e angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit të dhënat përgjithësisht dëshmojnë për një paqëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit mbi 30% e stafit akademik<sup>110</sup>. Konstatohet nga vizita në institucion se kontratat e punësimit të stafit efektiv me tituj dhe grada janë në kohë të pacaktuar, si dhe stafi akademik efektiv është i mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore<sup>111</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e</p>	<p>Institucioni ndjek një procedurë rekrutimi për personelin akademik sipas një mekanizmi të rregulluar në manualin e menaxhimit të burimeve njerëzore<sup>112</sup>, duke u bazuar në parimet e meritokracisë dhe profesionalizmit. Çdo fillim semestri, para se të fillojë mësimi, njësitë bazë dhe ato administrative identifikojnë nevojat për rekrutim stafi, e më pas merret konfirmimi nga Sekretari i Përgjithshëm dhe publikohet shpallja për vendet vakante në rrjetet</p>

<sup>107</sup> Evidenca Lista e Plotë e Stafit Akademik DSHETP

<sup>108</sup> Evidenca Aneks, Tabelat Përmbledhëse MP Arsim Special

<sup>109</sup> Evidenca Aneks, Tabelat Përmbledhëse MP Arsim Special, Tabela 4

<sup>110</sup> Evidenca 6. Lista e plotë e stafit të departamentit të shkencave të sjelljes dhe shëndetit

<sup>111</sup> Evidenca 7.4. Kontratë pune template

<sup>112</sup> Evidenca 7. Manuali i burimeve njerëzore



<p>duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>sociale të universitetit dhe në faqen zyrtare të tij, duke cilësuar kriteret e përgjithshme, të veçanta, e dokumentat e nevojshme<sup>113</sup>. Më pas krijohet një listë e aplikantëve që i përcillet një komisioni të posaçëm që bën vlerësimin paraprak, duke përcaktuar një listë të shkurtuar të aplikantëve që do të merren në intervistë. Komisioni i intervistës përbëhet nga drejtues dhe specialistë të fushës së ekspertizës, dhe mbas intervistimit të aplikantëve del me një vendim për aplikantin fitues. Aplikanti njoftohet me telefon dhe email nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Kandidati fitues njihet me kushtet e kontratës dhe nëse është dakord firmos kontratën. Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të Universitetit Barleti janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Duke iu referuar përzgjedhjes së stafit akademik, duhet të merret parasysh qëndrueshmëria e stafit, si dhe stafi i përzgjedhur të ketë profil në përputhje me modulet, lëndët dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në infrastrukturën për programin e studimit<sup>114</sup>, gjykojmë se Universiteti Barleti plotëson nevojat e studentëve të këtij programi studimi. Në lidhje me këtë kriter, duke analizuar kurrikulën e programit<sup>115</sup> të studimit konstatojmë se në të nuk ka orë laboratorike, por Universiteti ofron mjedise mësimore me cilësi të lartë, gjithashtu edhe zyrë këshillimi dhe vlerësimi që përdoret sipas nevojave që kanë studentët në kurse të specializuara. Gjithashtu, institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi laboratorët kompjuterikë dhe laboratorët e gjuhës së huaj të universitetit. Gjatë vizitës stafi ndihmës akademik shpjegoi të gjitha funksionet e sallave laboratorike, të cilat në disa raste specifike, në varësi të natyrës së modulit apo kursit përkatës, përdorej edhe nga studentët e programit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit</p>	<p>Universiteti Barleti, nëpërmjet Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional (DSHETP) dhe Drejtorisë të</p>

<sup>113</sup> Evidenca 36. Formati i dosjes personale të stafit

<sup>114</sup> Evidenca Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16

<sup>115</sup> Evidenca 2.1.b. Plani mësimor



<p>akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Burimeve Njerëzore<sup>116</sup> menaxhon të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Arsim Special”. Sektori i burimeve njerëzore është struktura përgjegjëse për mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon; ndjek ndryshimin e numrit të të gjithë personelit në institucion, të pagave përkatëse si dhe realizimit të tyre; nxjerr të dhënat e personelit që i nevojiten drejtuesve të institucionit. Stafit akademik dhe ndihmës akademik ka dosjet personale me të dhëna të plota. Këto të dhëna duhet të përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe konstatoi se dokumentacioni i tyre në disa raste nuk ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. Në disa raste, kontratat e punës nuk kishin të përcaktuar pagat e punonjësve sipas kritereve të kontratave të punës të vendosura në Kodin e Punës<sup>117</sup>, e në raste të tjera pagat i ishin shumë më të ulta se kufiri i pagave për punonjësit e institucioneve publike. Transparenca e kushteve të punës, e kritereve të pagave dhe arritja e standarteve të pagave me institucionet publike janë hapa që nevojiten për të zhvilluar motivacionin e punës midis anëtarëve të stafit akademik, qëndrueshmërinë e stafit akademik dhe zhvillimin e karrierës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen</p>	<p>UniBa ka nënshkruar marrëveshje me një sërë institucioneve dhe organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim krijimin e gjithë infrastrukturës së nevojshme për realizimin e praktikave profesionale, përmbylljen e studimeve të diplomës dhe të aktiviteteve të tjera formuese për programin e studimit “Master Profesional në Arsim Special”<sup>118119</sup>. Paketa e praktikës</p>

<sup>116</sup>Evidenca 7. Manuali i burimeve njerëzore

<sup>117</sup> Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë e marrë nga linku <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=93>

<sup>118</sup> Të dhënat mbi marrëveshjet e bashkëpunimit Tetor 2023

<sup>119</sup> Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të departamentit



dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	profesionale <sup>120</sup> përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve gjatë praktikave profesionale.			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	DSHETP në funksion të realizimit të objektivave formuese të programit të studimit MP në “Arsim Special” , si dhe në funksion të procesit mësimor ka nënshkruar marrëveshje institucionale me institucione prioritare për objektivat e programit si shkolla publike, private, dhe me institute e organizata që kanë prioritet arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta <sup>121</sup> . Gjithashtu, DSHETP po bën përpjekje të krijojë marrëveshje me Zyrën Arsimore Vendore Tiranë, në mënyrë që të lehtësohen procedurat e zhvillimit të praktikave duke pasur akses më të madh të studentëve për praktikë në shkollat publike të Tiranës.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në dokumentacionit për kualifikimin e stafit akademik, ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, kushtet e pagave të personelit, lëvizshmërinë e stafit nga viti i parë i programit në vitin e dytë të programit, del në konkluzionin se ky standard përmbushet pjesërisht. UniBa dhe DSHETP për të synuar arritjen e standardit plotësisht duhet të synojë rritjen e qëndrueshmërisë së stafit akademik, kualifikimin e vazhdueshëm dhe në përputhje me programin studimor të të gjithë stafit, kushte transparente të punës për të gjithë stafin, rrogat e stafit akademik të përafrohen të paktën me pagat e personelit akademik në institucionet publike, duke nxitur motivimin e punonjësve për kualifikim të mëtejshëm, si dhe pozicione pune të stafit akademik në funksion të zhvillimit të karrierës së tyre akademik dhe jo që ky pozicion të shoqërohet me pozicione të personelit administrativ.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## Standardi IV.2

<sup>120</sup> Evidenca 2.3. Paketa e praktikës profesionale

<sup>121</sup> Evidenca 22. Lista e Marrëveshjeve të departamentit

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UniBa për programin studimor siguron ambiente dhe mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, duke ofruar dy godina universitare<sup>122, 123</sup>. Këto godina ofrojnë auditore me kapacitete të ndryshme, me mjedise komode, ku në çdo auditor ka mjete teknologjike mbështetëse për të zhvilluar leksione dhe seminare ndëraktive. Gjithashtu, DSHETP ofron salla këshillimi dhe vlerësimi, në të cilat studentët mund të vëzhgojnë procesin e vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta, të ndërhyjnë sipas objektivave të kurseve që ofron programi. UniBa siguron ambiente ku studentët kanë mundësi të zhvillojnë aftësi profesionale teorike dhe praktike. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila është strukturuar në mënyrë të tillë që çdo pedagog të ketë hapësirën e tij për të punuar, kompjuterin individual, gjithashtu kjo zyrë shërben për mbledhje të departamentit. Gjithashtu, çdo drejtori apo njësi mbështetëse ka zyrën përkatëse si Njësia e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Burimet Njerëzore, zyra për IT, zyra për aktivitetet e qeverisë studentore, zyra për studentët, zyra e Kërkimit Shkencor, Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka etj<sup>124</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore</p>	<p>Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me mjete mbështetëse të teknologjisë së informacionit, si projektor, ëhiteboard, kompjuter, zyra të printimit dhe fotokopjimit për studentët. UniBa ka strukturuar dhe siguruar zyrë për vlerësim dhe këshillim praktik të studentëve gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të vëzhgojnë drejtpërsëdrejti procese të vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta, duke zhvilluar aftësi jo vetëm teorike por edhe praktike. Gjithashtu, në mjediset e universitetit ka dy laboratore mbështetëse për studentët për të zhvilluar aftësi kompjuterike dhe aftësi të mësimin të gjuhës së huaj<sup>125</sup>.</p>

<sup>122</sup> Evidenca 31.1. Të dhënat për infrastrukturën

<sup>123</sup> Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën

<sup>124</sup> Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën

<sup>125</sup> Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën



të mësimdhënies-mësimnxënies.	
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Duke u bazuar në dokumentacionin për infrastrukturën e godinave universitare të UniBa <sup>126</sup> , si dhe duke u bazuar në vizitën në institucion, rezulton se UniBa ofron laboratorë, zyra, mjedise mësimdhënëse-mësimnxënëse, apo mjedise të tjera të cilat plotësojnë kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik, dhe objektivat formues të programit të studimit në tërësi <sup>127</sup> . UniBa vë në funksion dy godina për të ofruar programin studimor, të cilat janë me hapësira të përshtatshme, e në të gjithë godinën studentët kanë akses në internet. Gjithashtu, mjediset monitoroheshin nga kamerat duke ofruar siguri të lartë në mjediset universitare.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	UniBa si institucion i arsimit të lartë, në strukturën e tij ka tre laboratore të informatikës <sup>128</sup> , ku veçanërisht studentët e programeve të informatikës dhe të teknologjisë së informacionit i shfrytëzojnë sipas objektivave të kurseve përkatëse. Programi i studimit Master Profesional në “Arsim Special” nuk ka në objektivat formues prioritet laboratorët e informatikës, por këto laboratorë mund të përdoren nga studentët e programit në rastet kur projektet e tyre në kurse të ndryshme kërkojnë të zhvillojnë aftësi kompjuterike. Zhvillimi i aftësive teorike dhe praktike për programin përkatës bazohet në përjasje të mësimdhënies ndëraktive <sup>129</sup> , e për të zbatuar principet e mësimdhënies ndëraktive, UniBa ka në infrastrukturën e tij salla të pajisura me mjete të teknologjisë, ehiteboard, zyrë për vlerësim të nxënësve me nevoja të veçanta. DSHETP ka krijuar marrëveshje me institucione publike <sup>130</sup> dhe jo publike për të zhvilluar praktika mësimore duke ofruar mundësi për zhvillim të aftësive profesionale.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet	Mësuesi i arsimit special, i cili ndryshe quhet mësues ndihmës, është një profesion i rregulluar <sup>131</sup> dhe si i tillë, është e nevojshme

<sup>126</sup> Evidenca 31. Raport i ekspertit për infrastrukturën

<sup>127</sup> Evidenca Aneks. Tabelat përmbledhëse MP Arsim Special

<sup>128</sup> Evidenca Aneks. Tabelat përmbledhëse MP Arsim Special

<sup>129</sup> Evidenca 16.3 Udhëzues i mësimdhënies

<sup>130</sup> Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të departamentit

<sup>131</sup> Urdhër për miratimin e standardeve profesionale të mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar Nr. 29, Datë. 20.1.2023 <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/FINAL-STANDARDI-E-MESUESIT-NDIHMES.pdf>

<p>që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>licensimi profesional. Në këtë rrugëtim profesional, praktika profesionale në programin studimor është bazike për të zhvilluar aftësi praktike profesionale. Kursi i praktikës profesionale është përcaktuar me 12 kredite<sup>132</sup> sipas kriterëve të vendosura për lëndët plotësuese në master profesional<sup>133</sup>, por në ngarkesën mësimore kjo lëndë figuron me 270 orë jo me 300 orë sipas ngarkesës duke përlogaritur kreditet përkatëse. DSHETP ka treguar kapacitete për të formuar bashkëpunime me institucione publike dhe jo publike për të zhvilluar praktikat profesionale por edhe aktivitete të tjera profesionale në funksion të objektivave të programit studimor<sup>134</sup>. Institucioni mund të zhvillojë më tej kapacitetet bashkëpunuese duke formuar marrëveshje me Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar Tiranë, duke mundësuar më shumë akses në shkolla të cikleve të ndryshme publike, dhe të karakteristikave të ndryshme si urbane apo periferike, duke krijuar mundësi për të parë më shumë kontekste të punës së mësuesit ndihmës. Gjithsesi, DSHETP është në përpjekje për të formuar një marrëveshje të tillë dhe ka marrë iniciativë bashkëpunimi me DAPT. Nga takimi në institucion, GVJ u informua se studentët që kanë ndjekur programin kanë qenë kryesisht mësues, të cilët duke qenë në punë, i është konvertuar praktika profesionale. Në rastet dy raste, studentët kanë bërë praktika në shkolla 9-vjeçare.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ duke shfletuar dokumentacionin përkatës dhe duke vëzhguar ambientet e godinave universitare, nxjerrë përfundimin se infrastruktura e vënë në dispozicion nga UniBa është në përputhje me objektivat e programit studimor, e përshtatshme dhe garanton realizimin e procesit të mësimdhënies-mësimnxënies ndëraktive, si dhe garanton mjedise për zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike. UniBa ka arritur të krijojë marrëveshje me institucione të rëndësishme publike dhe jo publike dhe ka marrë iniciativë që do të nxisin rritjen e kapaciteteve të bashkëpunimit me DAPT, në mënyrë që të garantojë një gamë të larmishme shkollash për praktikantët e studentëve. Një shqetësim në lidhje me praktikën profesionale është se kreditet e vendosura nuk përputhen me realizimin e orëve në terren. Për këtë arsye sugjerohet të rishihet kjo mospërputhje për të krijuar mundësi studentëve për të plotësuar normën e orëve të praktikës profesionale.</i></p>

<sup>132</sup> Evidenca 2.1.a Tabela e planit mësimor

<sup>133</sup> Vendim Nr.41, Datë 24.1.2018. Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. <https://www.ascal.al/media/documents/legjislacioni/VKM%20Nr.879%20dat%C3%AB%2018.12.2019.pdf>

<sup>134</sup> Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të departamentit

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>UniBa ka 3 mjedise për bibliotekën, ku nga këto tre mjedise, një mjedis ishte i organizuar me kompjutera personal dhe garantonte mjedis të qetë, por ky mjedis ishte shumë i kufizuar në krahasim me dy mjediset e tjera, të cilat ishin të integruara me ambiente të tjera. Nga ajo që vërehet në silabuse<sup>135</sup>, shpesh literatura e detyruar mbështet në cikle leksionesh të titullarëve apo pedagogëve të lëndëve përkatëse por pa referuar literaturën bazë nga janë marrë këto leksione as vitet përkatëse të literaturës. Leksionet nuk janë depozituar në bibliotekë. Literatura ndihmëse shpesh është një literaturë që ka nevojë për përditësim, pasi nuk është e 5 viteve të fundit. Përsa i përket literaturës në formë elektronike, UniBa ka krijuar një platformë online të rezervimit të librave që quhet Platforma Digjitale e Menaxhimit të Librit, e cila është një platformë e përhershme. Në këtë platformë studentët mund të kërkojnë dhe të rezervojnë online libra të cilat universiteti i ofron, e më së shumti këto janë libra në gjuhën shqipe por edhe në gjuhë të tjera që gjenden në libraritë kryesore në Shqipëri. Gjithashtu rezulton se universiteti ofron akses në motorin kërkimor JSTOR dhe ECONBIZ për studentët, ndërsa në platforma të tjera ky akses është i limituar dhe ofrohet vetëm për libra dhe artikuj që janë open access, pra që përdoren pa pagesë<sup>136</sup>. Lista e titujve të librave të ofruara nga biblioteka e UniBa është kryesisht në literaturë në gjuhën shqipe dhe jo në 5 vitet e fundit<sup>137</sup>. Sugjerohet të rishihet literatura duke u fokusuar në literaturë të përditësuar, në 5 vitet e fundit dhe të citohet literatura në silabus sipas stilit APA (versioni 7)<sup>138</sup>.</p>

<sup>135</sup> Evidenca. Syllabuse-Programme lëndore

<sup>136</sup> Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse

<sup>137</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve periodikëve në bibliotekë

<sup>138</sup> Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021. Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i titujve të librave në bibliotekë nuk është mundësuar, pavarësisht kërkesave të departamentit, nga vizita në institucion, rezulton se nuk ka një përditësim të literaturës së përditësuar ndërkombëtare në bibliotekë. Literatura bashkëkohore për programin është e kufizuar, dhe në bibliotekë gjenden shumë pak libra bashkëkohorë që janë drejtëpërsëdrejti të lidhura me programin mësimor. Gjithashtu, nuk ka një bibliotekë digjitale për libra bashkëkohorë të 5 viteve të fundit që lidhen drejtëpërsëdrejti me programin studimor. Nga GVJ sugjerohet të adresohet kjo situatë duke përditësuar literaturën, sidomos me libra të botimeve të fundit, të krijohet një metodologji për zgjedhjen e librave sipas kriterëve specifike, si dhe të përcaktohen procedura për përditësimin e literaturës sipas nevojave të departamentit për programin përkatës<sup>139140</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa ka 3 ambiente që i konsideron si biblioteka. Gjithsesi, dy nga këto ambiente janë të ndërthurura me ambiente të tjera të institucionit, ku njëri nga këto dy ambiente krijon më shumë mundësi të leximit në qetësi, ndërsa ambienti tjetër është më i zhurmshëm. Ambienti i bibliotekës i veçuar nga mjedise të tjera ishte me hapësirë të shumë të vogël, përafërsisht me kapacitet 25-30 persona, por i pajisur me kompjutera personal, ku studentët mund të shfletonin literatura digjitale. Në shfletimin e literaturave digjitale, studentët kishin mundësi të klikonin në një faqe të përgatitur nga stafi i bibliotekës dhe të klikonin në motor kërkimor të ndryshëm që ofronin akses të lirë të literaturave, por studentët nuk mund të aksesojnë literatura të cilat nuk ishin me akses të lirë, përveç në rastin e kërkimit në JSTOR<sup>141</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për</p>	<p>Në UniBa fondi fizik i bibliotekës ishte shumë i kufizuar. Një pjesë e konsiderueshme e programve lëndore bazohej në leksione të pedagogëve apo titullarëve të lëndëve, të cilat nuk depozitoheshin në bibliotekë. Literatura akademike nuk është e përditësuar për 5 vitet e fundit në të shumtën e rasteve. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës në shqip nuk lidhet drejtëpërsëdrejti me literaturën e detyrueshme të programit, apo me literaturë që mund të jetë në funksion të programit<sup>142</sup>.</p>

<sup>139</sup> Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse

<sup>140</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve periodikëve në bibliotekë

<sup>141</sup> Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse

<sup>142</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve periodikëve në bibliotekë

mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UniBa ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë të bibliotekës online për studentët e saj në fushën e programit përkatës. Gjithsesi, kapacitetet e bibliotekës garantojnë një shfrytëzim të kufizuar të literaturës online <sup>143144</sup> . Platforma Digjitale e Menaxhimit të Librit është një platformë që UniBa garanton për studentët, e në këtë platformë studentët mund të rezervojnë libra online, por kjo literaturë është më së shumti në shqip dhe botimet janë të larmishme por është e kufizuar të gesh botime të përditësuara, akademike e që lidhen direkt me tema në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu, UniBa mundëson vetëm një motor kërkimor me akses të plotë pa pagesë për studentët, që shfrytëzohet në kushte të barabarta, JSTOR, por për motorët e tjerë kërkimor aksesit është i kufizuar. UniBa nuk ofron platformën e bibliotekës digjitale Ulibrary dhe aksesin në EBSCO. Studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në bibliotekë e të marrin shërbimin e bibliotekës falas.
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka në UniBa është pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim të bibliotekës nga të gjithë studentët. Por, ky ambient ka kapacitet të ulët, pasi është përafërisht e strukturuar për 25-30 vende të shfrytëzimit të bibliotekës duke përdorur kompjutera. Për të lexuar, në UniBa, kishte një ambient të dytë ngjitur me sallën e kompjuterave të bibliotekës me përafërisht 40 vende leximi. Ky ambient edhe pse më i qetë nuk ishte i shkëputur nga ambientet e tjera të godinës <sup>145</sup> .
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre,	Biblioteka në UniBa funksionon në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, në nivel Bachelor dhe master, në mënyrë që studentët të kenë hapësira të mjaftueshme të shfrytëzojnë bibliotekën për nevojat e tyre studimore. Oraret e bibliotekës janë 09.00-20.00.


<sup>143</sup> Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse

<sup>143</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve periodikëve në bibliotekë

<sup>144</sup> Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse

<sup>144</sup> Evidenca 30. Lista e teksteve periodikëve në bibliotekë

<sup>145</sup> Evidenca Aneks. Tabelat Përmbledhëse



<p>në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	
<p><b>Kriteri 8.</b>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk jep një procedurë të bashkëpunimit midis bibliotekës dhe DSHETP<sup>146</sup> për të raportuar mbi fondin fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit si nga personeli akademik dhe studentët e programit përkatës. Në dokumentacion mungon një relacion vjetor të këtij përditësimi. I vetmi dokumentacion që tregon një fond për bibliotekën gjenden në burimet financiare të universitetit, ku jepet një tabelë shpenzimesh për vitet 2020 deri në 2020, e më pas jepet një plan i shpenzimeve për vitin 2023-2024, ku parashikohet një fond librash të huaj dhe të vendit, por nuk specifikohen programet përkatëse<sup>147</sup>. Nga vizita e GVJ si me stafin akademik, me përgjegjësin e departamentit dhe me punonjësit e bibliotekës rezultoi se departamenti bën vazhdimisht kërkesë për përditësim literature fizike dhe digjitale, por literatura e përditësuar ndërkombëtar garantohet në raste të veçanta për mungesë fondesh.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ arrin në konkluzionin se është bërë një përpjekje e rëndësishme për të krijuar hapësira studentëve për të shfletuar literaturën në shqip dhe në gjuhën e huaj. Por, ky proces ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, në hapësira të veçuara, të cilat plotësojnë standartet për mungesë zhurmash për lexim. Gjithashtu, programi studimor duhet të garantojë literatura të 5 viteve të fundit, e këto literatura të ofrohen në cikle leksionesh të përditësuar në gjuhën shqipe, të gjenden kopjet fizike dhe digjitale të këtyre literaturave dhe literaturave origjinale në gjuhët përkatëse. Rekomandohen më shumë hapësira fizike për librat fizikë për programin studimor, si</i></p>

<sup>146</sup> Evidenca 35.a Raport vjetor i departamentit

<sup>147</sup> Evidenca 40. a Burimet financiare





	<i>dhe më shumë mundësi për studentët të shfletojnë literaturën në motor kërkimor të tjerë ku të kenë akses të plotë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UniBa disponon një sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron informacionet që lidhen me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim që është intranet, portali studentor online <sup>148149</sup> . Sektori IT është përgjegjës për menaxhimin e këtyre sistemeve, udhëzimet, ndjekjen e procedurave për regjistrimin online të studentëve dhe për përditësimin e portalit, për ruajtjen digjitale të dokumentacionit për studentët, për stafin akademik dhe institucionin <sup>150151152153154155156</sup> . Por, gjatë takimeve me studentët e programit, rezultoi se përdorimi i këtyre sistemeve nuk ndodh me studentët e masterit profesional në arsim special. Studentët e këtij masteri shprehën se përdorin sisteme jo formale online si google classroom dhe jo intranet, duke përdorur adresat e tyre personale të gmail-it dhe jo ato të personalizuara nga institucioni e që i jep akses në një gamë të gjerë shërbimesh dhe të dhënash në lidhje me progresin e tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Sipas dokumentacionit të DVV-së, UniBa aplikon struktura të teknologjisë dhe të përdorimit të sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit për aktivitetin e personelit

<sup>148</sup> Evidenca 37. Manuali i përdorimit të portalit studentor

<sup>149</sup> Evidenca 38.d. Manual përdorimi intranet

<sup>150</sup> Evidenca 37. Manuali i përdorimit të portalit studentor

<sup>151</sup> Evidenca 38.d. Manual përdorimi intranet

<sup>152</sup> Evidenca 38.e Manual përdorimi të SIS Classter për studentët

<sup>153</sup> Evidenca 19.1. Rregullore e Sekretarisë Mësimore

<sup>154</sup> Evidenca 34. Rregullore Protokoll Arkive

<sup>155</sup> Evidenca 38.c Manual GSUIT

<sup>156</sup> Evidenca A1.38 Raporti vjetor UniBa viti akademik 2022-2023

<p>akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>akademik<sup>157</sup>158159160161. Nga diskutimet me stafin akademik, u konfirmua përdorimi i intranet si një metodë online për menaxhimin e informacionit në lidhje me aktivitete të ndryshme mësimore, kërkimore dhe administrative. Gjithashtu, gjatë intervistimit të stafit rezultoi që përdoret gjithashtu edhe platforma google classroom. Stafi administrativ konfirmoi lehtësinë në përdorimin dhe ruajtjen e informacioneve me anën e sistemit intranet. Sipas këtij stafi, informacioni ruhet në gjendje fizike dhe digjitale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pavarësisht se UniBa ka organizuar sistem të menaxhimit të informacionit online<sup>162</sup>, ku sigurohet akses i dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët, në rastin e programit master në arsim special, ky sistem nuk aplikohet me studentët. Në këtë program, studentët, informacionet për kurrikulën e programit, për oraret, strukturën e vitit akademik, i marrin me anën e komunikimit me pedagogët përkatës në platformën google classroom. Gjithashtu, informacione më të detajuara në lidhje me datat e provimeve, riprovimeve, punësimet, studentët i gjejnë në sitet e universitetit si dhe rrjetet sociale. Këto forma të komunikimit ishin shumë të përdorura nga to.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>DSHETP ka krijuar një rrjet komunikimi të brendshëm midis stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të programit që i përgjigjet nevojave reale, shpejt dhe me efikasitet. Ky komunikim ndodh më së shumti në nivel sistemesh të mësimdhënies në platforma me akses të lirë si google classroom, me anën e rrjeteve sociale si facebook, instagram, tittok, X, LinkedIn, dhe sitit të internetit, ku ka një hapësira të dedikuara stafit administrativ, stafit akademik, studentëve, punësimet, karrierës dhe njoftimeve në kohë reale<sup>163</sup>. Nga takimet në institucion, e veçanërisht takimet me studentët, këto platforma komunikimi ishin shumë praktike për to, por ato shprehen se do të donin sisteme akoma më të specifikuar ku të mund të shfrytëzonin maksimalisht nga sistemi shfletimin e literaturës, regjistrimin online në provime, apo informimin e individualizuar në lidhje me vlerësimin me nota.</p>

<sup>157</sup> Evidenca 37. Manuali i përdorimit të portalit studentor

<sup>158</sup> Evidenca 38.d. Manual përdorimi intranet

<sup>159</sup> Evidenca 19.1. Rregullore e Sekretarisë Mësimore

<sup>160</sup> Evidenca 34. Rregullore Protokoll Arkive

<sup>161</sup> Evidenca 38.c Manual GSUIT


<sup>162</sup> Evidenca 37. Manuali i përdorimit të portalit studentor

<sup>163</sup> <https://www.umb.edu.al/>

<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi teknologjik i menaxhimit të informacionit, intranet që ofrohet nga institucioni, në rastin e këtij programi studimor nuk aplikohet me studentët e programit. Më së shumti, për studentët, informimi në kohë reale realizohej me anën e platformave të rrjeteve sociale, apo të google classroom. Gjithashtu, UniBa ka një faqe interneti ku përditësohet vazhdimisht me informacione në interes të studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>UniBa në faqen zyrtare siguron informacion në shqip dhe në anglisht në lidhje me programet studimore, procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve, informacione për studentët, stafin akademik, për zhvillimin e karrierës, punësimin, aktivitetin kërkimor. Gjithashtu, në faqen e internetit jepen linqe të aksesueshme si E-Albania, Matura Shtetërore.<sup>164</sup> Në këtë faqe mund të akses dhe në rrjetet sociale të UniBa.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në konkluzion, duke u bazuar në dokumentacionin e DVV si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ gjykon se UniBa disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional Intranet. Ky sistem përdoret më shumë nga punonjësit e administratës, personelit akademik dhe ndihmës akademik, por në programin e studimit master profesional në arsim special, nuk përdoret nga studentët. UniBa dhe DSHEP ka vënë në dispozicion platforma komunikimi për studentët me anën e rrjeteve sociale, faqes së internetit, platformave të mësimit online, por ky sistem ka nevojë të aplikohet tek studentët e programit të masterit profesional në arsim special.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<sup>164</sup> <https://www.umb.edu.al/>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga DVV, vihet re se nuk sigurohet një plan financiar i Institucionit për programin studimor. Dokumentet në DVV për menaxhimin e financave janë dokumentet për burimet financiare<sup>165</sup> dhe të raportit vjetor<sup>166</sup>. Në dokumentin e të dhënave nga raporti financiar vjetor institucional<sup>167</sup>, tabela udhëzon ti referohemi dokumentit të burimeve financiare<sup>168</sup>. Në raportin vjetor akademik 2022-2023 institucional, shprehet se Zyra e Financës, nën drejtimin e Administratorit, hartojnë raport të hollësishëm të kostove për realizimin e programeve të studimit duke bërë parashikime për periudha afatmesme, por ky plan për programin nuk është i evidentuar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra</p>	<p>UniBa në raportin vjetor raporton për plane të hollësishme financiare në nivel programesh studimesh<sup>169</sup>, por në dokumentin për burimet financiare<sup>170</sup> evidentohet një plan i përgjithshëm institucional për menaxhimin e të ardhurave, ndërkohë që plani i financimit të programit që është pjesë e njësisë kryesore dhe njësisë bazë mungon. Nga takimet me përgjigjësën e departamentit, stafin akademik dhe administrativ vihet re se përgjegjësia e menaxhimit të financimit është në nivel të Zyrës së Financës dhe se në zëra që lidhen me programin stafi akademik dhe përgjegjësi i departamentit bëjnë konsulta dhe krijohen hapësira të vendimmarrjes së bashku me njesinë bazë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik,</p>	<p>UniBa në raportin vjetor institucional<sup>171</sup> menaxhon kontrollin financiar me anën e auditeve të brendshme dhe të jashtme. Këto</p>

<sup>165</sup> Evidenca 40. a Burimet financiare

<sup>166</sup> Evidenca A1.38 Raporti vjetor UniBa viti akademik 2022-2023

<sup>167</sup> Evidenca 39. Të dhënat nga raporti financiar vjetor institucional

<sup>168</sup> Evidenca 40. a Burimet financiare

<sup>169</sup> Evidenca A1.38 Raporti vjetor UniBa viti akademik 2022-2023

<sup>170</sup> Evidenca 40. a Burimet financiare

<sup>171</sup> Evidenca A1.38 Raporti vjetor UniBa viti akademik 2022-2023



<p>vlërëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>audite realizohen në periudha të caktuara, çdo një vit dhe realizohen nga institucioni por edhe kompani auditit ndërkombëtare të regjistruara në Shqipëri (kompania Grant Thornton shpk), por edhe kontrole nga Drejtoria e Tatim Taksave. Raportet e auditit dhe rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e senatit akademik. Por, nga DVV nuk figuron një raport vjetor i auditit, dhe sugjerohet dokumentimi i auditit për çdo periudhë kohore, si auditit brenda institucionit dhe atyre jashtë institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në burimet financiare UniBa<sup>172</sup> raporton mbi vitet 2020-2022 për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra, e më pas jep një pasqyrë të veprimtarisë së parashikuar për vitin akademik 2023-2024. Në dokumentin e vënë në dispozicion nuk ka të dhëna specifike për programin studimor. Nga dokumentat në DVV si dhe nga ato të marra mbas vizitës, nuk është dërguar realizimi i buxhetit në njësinë kryesore dhe bazë në lidhje me realizimin e programit. GVJ rekomandon që të krijohet një sistem menaxhimi financiar që përfshin jo vetëm Zyrën e Financave por edhe njësinë kryesore dhe atë bazë, në mënyrë që të realizohet një buxhet financiar sa më efikas dhe në përputhje me nevojat ekonomike të programit studimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion<sup>173174175</sup>, rezulton se ka një mungesë në dokumentacionin mbi raportet vjetore financiare, si në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Pavarësisht, se në raportin institucional shprehet se ka qëndrueshmëri financiare, mungesa e dokumentacionit përkatës tregon një mosevidentim të qëndrueshmërisë financiare. Nga burimet financiare, vërehet se baza e të ardhurave financiare vjen nga tarifat e shkollimit, por jo nga fonde të tjera të cilat mund të rrisin sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare, si p.sh. të ardhura nga projekte kërkimore apo nga fonde të fituara publike ose jo publike. Hartimi i një raporti specifik financiar për çdo program studimor dhe planifikimi në nivel afatmesëm dhe afatgjatë duke marrë në konsideratë rrisqet dhe menaxhimin e tyre, mund të krijojë më shumë objektivitet për qëndrueshmërinë financiare.</p>

<sup>172</sup> Raporti vjetor UniBa viti akademik 2022-2023

<sup>173</sup> Evidenca A1.38 Raporti vjetor UniBa viti akademik 2022-2023

<sup>174</sup> Evidenca 40. a Burimet financiare

<sup>175</sup> Evidenca 39. Të dhënat nga raporti financiar vjetor institucional

<b>Konkluzione</b>	<i>Në konkluzion, GVJ rekomandon një analizë më të hollësishme të buxhetit financiar si në nivel institucioni, të njësisë kryesore dhe njësisë bazë duke evidentuar këtë proces. UniBa garanton financim për realizimin e programit, por ky financim nuk evidentohet si i qëndrueshëm në kohë, e gjithashtu nuk evidentohet nëse njësitë bazë kanë kapacitete të menaxhojnë në mënyrë efikase burimet financiare për programet e tyre, dhe rekomandohet që çdo program të ketë një buxhet specifik të implementimit të tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në</b>	UniBa ka hartuar politika, aktet vetërregulluese dhe procedura <sup>176177178179180181182183</sup> sipas kuadrit ligjor <sup>184</sup> për të rregulluar ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja dhe zbaton politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve. Në statutin dhe rregulloren e UniBa, përcaktohen politikat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin, dhe largimin e studentëve por

<sup>176</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>177</sup> Evidenca 19. Rregullore e brendshme për transferimet

<sup>178</sup> Evidenca 33.a Rregullore e Këshillit të Etikës dhe Shanseve të Barabarta

<sup>179</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>180</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>181</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti

<sup>182</sup> Evidenca 1.3 Rregullore e DSHETP

<sup>183</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS

<sup>184</sup> Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22\_07\_2015 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/P%C3%ABrmbledhje-e-legjislacionit-p%C3%ABr-arsimin-e-lart%C3%AB-perditesuar-deri-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf>

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	edhe detyrimet e tyre. Gjithashtu, këto politika janë reflektuar në rregulloren e fakultetit, departamentit, në rregullore e programit të studimit si dhe në rregulloren e zyrave për studentët dhe rregulloren për transferimin e programeve dhe regjistrimin në programe të dyta.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UniBa mbështetet në rregulloret e tij <sup>185</sup> 186187188189, dhe sipas politikave të hartuara, akteve vetrregulluese për procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademike të studentëve nga hyrja në dalje, siguron të drejtat të barabarta dhe të plota për të gjithë studentët <sup>190</sup> . Nga shqyrtimi i DVV-së por edhe vizitës në institucion me studentët, me dekanin e studentëve, personelin ndihmës në sekretarinë mësimore, vihet re një angazhim maksimal për të garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët e programit mësimor.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	DSHETP propozon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve <sup>191</sup> . Më pas merret miratimi në nivel njësie kryesore dhe senati akademik <sup>192</sup> . UniBa në faqen zyrtare të internetit, siguron të gjithë informacionin e nevojshëm për të orientuar maturantët për kriteret e pranimit dhe procedurat e aplikimit si dhe studentët për transferim studimesh apo për studime të dyta. Gjithashtu, informacionet shpallen në tendat përkatëse pranë sekretarisë apo departamentit për programin studimor <sup>193</sup> 194. Nga shqyrtimi i DVV, rezultoi se vendimi për kriteret e programit studimor nuk ishin në listën e kriterëve të programit që ofron DSHETP për vitin akademik 2022-2023 dhe për vitin akademik 2023-2024 <sup>195</sup> , periudhë e akreditimit të programit. Mbas kërkesës së GJV për të shtuar evidencat për kriteret e pranimit, janë dërguar kriteret e pranimit për vitin 2024-2025, ku specifikohet kriteri i mesatares sipas legjislacionit në fuqi <sup>196</sup> . Nga të dhënat e mesatareve hyrëse <sup>197</sup> del se mesataret hyrëse të studentëve për programin master profesional në arsim special janë 6 për vitin akademik 2022-2023 dhe 6.2 për vitin akademik 2023-2024, mesatare jo në

<sup>185</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>186</sup> Evidenca 19. Rregullore e brendshme për transferimet

<sup>187</sup> Evidenca 33.a Rregullore e Këshillit të Etikës dhe Shanseve të Barabarta

<sup>188</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>189</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>190</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>191</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>192</sup> Evidenca 20.6 Vendimet për miratimin e kriterëve të studentëve

<sup>193</sup> <https://umb.edu.al/transferohu.html>

<sup>194</sup> <https://umb.edu.al/pranimet.html>

<sup>195</sup> Evidenca 20.6 Vendimet për miratimin e kriterëve të studentëve

<sup>196</sup> Evidenca 20. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025

<sup>197</sup> Evidenca Aneks. Tabelat përmbledhëse MP Arsim Special

	përputhje me kuadrin ligjor për kriterin e mesatares në programet studimore të mësuesisë <sup>198</sup> . Gjithashtu, në broshurën e faqes zyrtare të UniBa për programin studimor nuk përcaktohet si kriter hyrës mesatarja sipas kuadrit ligjor në fuqi <sup>199</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UniBa ka platforma të komunikimit për procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve për programet përkatëse, për përparimin përgjatë kursit të studimit, të transferimit, të njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cila janë të pasqyruara në faqen zyrtare <sup>200201</sup> , në statut, rregulloren e institucionit, rregullore të DSHETP dhe të programit studimor <sup>202203204205206</sup> . Por, kriteret e pranimit nuk janë të evidentuara sipas kuadrit ligjor për kriterin e notës mesatare për programet e mësuesisë, si dhe nga të dhënat aktuale viheret re që ky kriter nuk është plotësuar pasi studentët në programin e këtij masteri të mësuesisë kanë hyrë me mesatare 6 dhe 6.2. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në UniBa shpreh se procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve nuk janë në përputhje me VKM <sup>207</sup> në fuqi për kriterin e mesatares hyrëse për programet e mësuesisë. Vendimi i senatit akademik nuk është transparent për kriterin e mesatares dhe kuotat e pranimit.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në faqen zyrtare të UniBa gjenden informacione për të interesuarit dhe publikun mbi kriteret e programit të studimit. Në rastin e programit studimor të mësuesisë në arsim special, vihet re se këto kritere janë të përgjithshme jo të veçanta e specifike për përcaktimin e mesatares sipas kuadrit ligjor <sup>208</sup> . Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Klubin e Karrierës organizon Panairin e Punës duke ftuar ish studentë, Alumni <sup>209</sup> , të diplomuar dhe të interesuar të cilët dëshirojnë të studiojnë pranë UniBa <sup>210</sup> . Gjithashtu, UniBa organizon ditët e informimit dhe promovimin e programeve <sup>211</sup> si

<sup>198</sup> Vendim Nr. 46, Datë. 27.1.2021 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf>

<sup>199</sup> Broshura Master Profesional në Mësuesi Arsim Special <https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/VOLANT-mp-ne-arsim-special-upm-23.pdf>

<sup>200</sup> <https://admission.umb.edu.al/>

<sup>201</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>202</sup> Evidenca 19. Rregullore e brendshme për transferimet

<sup>203</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>204</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti

<sup>205</sup> Evidenca 1.3 Rregullore e DSHETP

<sup>206</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>207</sup> Vendim Nr. 46, Datë. 27.1.2021 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf>

<sup>208</sup> <https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-ne-arsim-special.html>

<sup>209</sup> Evidenca A.1.33 Plani Strategjik Alumni

<sup>210</sup> <https://students.umb.edu.al/news5650.html>

<sup>211</sup> Evidenca 49. Agjenda e javës orientuese



	dhe informon vazhdimisht me botimin e revistës studentore <sup>212</sup> , studentët aktualë dhe ato që kanë interes të studiojnë në programet e UniBa për jetën studentore, shërbimet e marra në UniBa dhe kriteret e pranimit në programet e studimit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi organizimin e ditëve të informimit, si dhe angazhimit të institucionit për të promovuar programet studimore me anën e informimit dhe ndërgjegjësimit të interesuarve për të ndjekur studimet në UniBa, dhe veçanërisht në programin e masterit profesional në arsim special. Siç u shpreh më lartë, një shqetësim në lidhje me informimin e kriterëve për pranimin në programin e studimit është mesatarja sipas kuadrit ligjor, aspekt ky kritik që nuk evidentohet për kriteret e pranimit në vitin akademik 2022-2023 dhe 2023-2024.
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Nga shqyrtimi i DVV, nuk rezulton të jenë hartuar politika për kriteret të veçanta për përzgjedhje të kandidatëve nga grupet e marginalizuara, grupet e pakicave. Në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton të krijohen kriteret të veçanta në raste kur kandidatët shfaqin aftësi të veçanta dhe të larta që dallojnë për këto aftësi <sup>213214215216</sup> .
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UniBa nuk përcakton kriteret shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Në kriteret e përcaktuara nuk ka kufizime për kandidatë që aplikojnë nga shtete të tjera, por përcaktohet që për secilin kandidat që ka një diplomë jashtë Shqipërisë të bëhet njësimi sipas procedurave ligjore përpara aplikimit për programin studimor dhe të dorëzohet diploma e njëhsuar <sup>217218219220</sup> .
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për	UniBa në rregullore e tij <sup>221</sup> përcakton dhënien e bursave për studentë, dhe përcakton akte normative <sup>222</sup> . Në faqen zyrtare të UniBa, specifikohen bursa të ekselencës 1 vjeçare për maturantët, bursa merite për maturantët me merita të spikatura dhe bursa

<sup>212</sup> <https://students.umb.edu.al/revista-studentore.html>

<sup>213</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>214</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti

<sup>215</sup> Evidenca 1.3 Rregullore e DSHETP

<sup>216</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS

<sup>217</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS

<sup>218</sup> Evidenca 1.3 Rregullore e DSHETP

<sup>219</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>220</sup> <https://umb.edu.al/pranimet.html>

<sup>221</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti

<sup>222</sup> Evidenca 20. Rregullore zyrave studentore

të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	sociale të pjesshme një vjeçare për studentët me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara, me vështirësi ekonomike familjare, apo kur është fëmijë i një polici të vrarë <sup>223</sup> . Në dokumentacionin e DVV nuk ka shembuj të vendimeve të komisioneve ad hoc apo të Bordit të Administrimit për të evidentuar dhënien e bursave për studentët e këtyre kategorive.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ arrin në konkluzionin se UniBa ka hartuar politika mbi procedurat e pranimit, përzgjedhjes, përparimit të studentëve të programit master profesional në arsim special, si dhe procedura të transferimit të studimeve, të njohjes së studimeve dhe të diplomimit të studentëve. GVJ evidentoi që kriteret e pranimit në këtë program mësuesie duhet të jenë transparente dhe konform kuadrit ligjor, duke respektuar kriterin e pranimit sipas mesatares për programet e e mësuesisë, kriter që nuk është zbatuar. Gjithashtu GVJ rekomandon zgjerimin e politikave në kuadër të grupeve të pakicave dhe të marginalizuarëve. UniBa sipas rregullores së saj mbështet studentët me bursa, por institucioni duhet të evidentojë raste të marrjes së këtyre bursave nga studentët sipas specifikave përkatëse.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UniBa me anën e rregulloreve në nivel institucioni, njësisë kryesore, njësisë bazë dhe të programit të studimit, dhe me anën e faqes zyrtare të tij, rrjeteve sociale, vë në dispozicion informacione të rëndësishme për procedurat e përparimit akademik të studentëve, për kriteret e kalimit nga një vit akademik në vitin tjetër akademik, si dhe informacione për kriteret e pranimit <sup>224</sup> . Për kriteret e pranimit, informacioni për notën mesatare në programin e studimit mungon. Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një

<sup>223</sup> <https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html>

<sup>224</sup> <https://students.umb.edu.al/revista-studentore.html>

	vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit <sup>225226227</sup> dhe rregulloren e programit të studimit <sup>228</sup> . Në takimin me studentët, rezultoi se ato ishin të informuar mbi detyrimet dhe të drejtat e tyre si studentë, detyrimet për programet lëndore dhe detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogët përgjegjës.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UniBa ka procedura dhe akte vetrregulluese <sup>229</sup> për të orientuar kandidatët për të studiuar në programet që institucioni ofron duke publikuar kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme të studimeve të tyre. Gjithashtu, në programet lëndore janë të shprehura informacionet për kreditet e lëndëve, temat specifike të lëndëve, vlerësimi i dijeve, aftësitë që synohen të zhvillohen në programet lëndore, duke mundësuar procesin e konvertimit, njehsimit të kualifikimeve të studimeve të mëparshme <sup>230</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UniBa ka në dispozicion rregulloren e programit ku studentët informohen për vlerësimin e dijeve dhe aftësitë që programi synon të zhvillojë <sup>231</sup> . Gjithashtu, studentët informohen mbi procedurat e vlerësimit të dijeve në syllabuset e lëndëve <sup>232</sup> . Gjatë takimit që GVJ pati me studentët e programit, rezultoi se ato kishin informacione të larta mbi çdo procedurë vlerësimi dhe zhvillimi të aftësive që lidhen me programin studimor. Sipas tyre, pedagogët e lëndëve informojnë vazhdimisht studentët në lidhje me detyrimet, vlerësimin e vazhdueshëm të dijeve dhe aftësitë që zhvillohen në kurset përkatëse.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Sipas rregullore së studimit, neni 16 <sup>233</sup> , studentët e programit nuk diplomohen me punim të diplomës, por me një provim të përgjithshëm, që quhet prova finale. Në planin mësimor të programit <sup>234</sup> nuk rezultoi tema e diplomës si kriter i provës finale, por përcaktohet provimi i përgjithshëm si detyrime përmbyllëse. Kriteret dhe procedurat e provës finale janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti	UniBa nëpërmjet faqes zyrtare në internet, rrjeteve sociale <sup>235</sup> , javës orientuese <sup>236</sup> , klubeve studentore, synon të informojë studentët e

<sup>225</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti

<sup>226</sup> Evidenca 1.3 Rregullore e DSHETP

<sup>227</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS

<sup>228</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>229</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit Barleti

<sup>230</sup> Evidenca. Syllabuse-Programme lëndore

<sup>231</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit Master Profesional në Arsim Special

<sup>232</sup> Evidenca. Syllabuse-Programme lëndore

<sup>233</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MP në Arsim Special

<sup>234</sup> Evidenca 2.1.b Plani mësimor

<sup>235</sup> <https://www.umb.edu.al/>

<sup>236</sup> Evidenca 49. Agjenda e javës orientuese

akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	ardhshëm për programet e studimit që ofron. UniBa ka një larmi broshurash në funksion të promovimit dhe informimit rreth shërbimeve, programeve të studimit që ofron.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ pas shqyrtimit të DVV dhe pas takimeve në institucion, konkludon se UniBa ka vënë në dispozicion të studentëve të programit studimor të gjithë informacionin e duhur për studentët e që lidhet me procedura, aktivitete, kritereve të vlerësimit të dijeve, aftësitë që zhvillon program, detyrimet dhe përgjegjësitë e studentëve, të pedagogëve, të stafit ndihmës akademik, të administratës në mënyrë që studentët të jenë të orientuar gjatë procesit studimor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë vizitës së GVJ, rezultoi se studentët ishin shumë të informuar mbi strukturën, organizimin, tarifat, kreditet që duheshin për të kaluar në vitin pasardhës. Informacioni merrej nga zyrat e studentëve, sekretaria mësimore, lajmërimet e pedagogëve për lëndët përkatëse, lajmërimet në stendat përkatëse në departamente, në sekretari, në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale. Studentët gjatë javës së parë të studimeve orientohen për programin studimor, për detyrime dhe shërbimet në funksion të arritjeve akademike <sup>237</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion	Informacionet e rëndësishme për studentët si për shembull rregullorja e programit të studimit, apo rregullorja e zyrës së studentëve, vireshin

<sup>237</sup> Evidenca 49. Agjenda e javës orientuese

dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	në dispozicion të studentëve përmes faqes së internetit <sup>238</sup> , komunikimit me pedagogët me anën e platformës së Google Classroom, gjatë javës së orientimit, gjatë aktiviteteve të klubeve studentore, me anën e syllabuseve. Gjatë vizitës në institucion GVJ-së, iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Për të mbështetur studentët për orientimin drejt tregut të punës, UniBa ka organizuar struktura që monitorojnë dhe orientojnë studentët për punësim. Këto struktura janë Zyra e Karrierës dhe Alumni <sup>239</sup> , Bordi i Karrierës <sup>240</sup> , Klubi i Karrierës <sup>241</sup> , si dhe shërbimet e punësimit që ofrohen nga Am-Barleti Human Capital <sup>242</sup> , në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit <sup>243</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Pavarësisht se institucioni UniBa ka një sistem të menaxhimit të informacionit të brendshëm, ky sistem nuk përdorej me studentët e këtij programi studimor. Gjatë vizitës së GVJ në institucion, rezultoi se studentët përdornin adresat e tyre personale në komunikimet me stafin akademik, apo komunikime të tjera me stafin administrative, personelin ndihmës akademik. Gjithsesi, studentët ishin të mirëinformuar mbi organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të programit. Kjo falë komunikimit të vazhdueshëm me stafin akademik, përgjegjësën e departamentit, zyrave studentore dhe stafit të sekretarisë mësimore.
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes platformave alternative tek studentët e këtij masteri dhe jo përmes Intranet, sistemit të brendshëm të informacionit që universiteti ofron. Studentët e programit përdornin platformën Google Classroom, si një platformë ku mundësohej online marrja e leksioneve, dorëzimi i projekteve, marrja e njoftimeve për programet lëndore. Kjo platformë e përdorur lehtëson komunikimin e shpejt dhe në kohë reale të studentëve pavarësisht distancave të tyre.

<sup>238</sup> <https://umb.edu.al/en/dossier-UniBa.html>

<sup>239</sup> <https://umb.edu.al/zyra-e-karrieres-dhe-alumni.html>

<sup>240</sup> Evidenca 28. Bordi i Karrierës

<sup>241</sup> Evidenca 20.2. Strategjia e Klubeve Studentore 2020-2025

<sup>242</sup> <https://humancapital.al/>

<sup>243</sup> Evidenca A.1.33 Planit Strategjik Alumni

<b>Konkluzione</b>	<i>Në përfundim, GVJ vlerëson se studentët ishin të informuar mbi procesin mësimor, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit, objektivat e programeve lëndore, mundësitë e punësimit, shërbimeve që ofron UniBa në funksion të zhvillimit të karrierës dhe punësimit. Pavarësisht se për këtë program studimi nuk përdorej një sistem i menaxhimit të informacionit të brendshëm, format alternative të platformave të komunikimit dhe ndërveprimit online janë përdorur me rezultat dhe kanë qenë shumë komode për studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Programi i masterit profesional në “Arsim Special” është hapur në vitin akademik 2022-2023. Në përfundim të këtij viti akademik, diplomohet grupi i parë i studentëve. Statistikat për këtë grup lidhen me numrin e studentëve që janë regjistruar në program, numrin e studentëve që vazhdojnë programin, numrin e studentëve që e kanë lënë programin, mesataret hyrëse <sup>244</sup> . Gjatë vizitës së GVJ, personeli ndihmës akademik në sekretari konfirmoi ruajtjen e të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore administronte një regjistër duke ruajtur vlefshmërinë e procedurave të hedhjes së informacioneve por nuk kishin një regjistër themeltar të studentëve nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Referuar tabelës 21 <sup>245</sup> , vihet re se <b>për vitin akademik 2022-2023, numri i regjistrimit të studentëve të rinj në program është 49</b> , por mesatarja e tyre 6, dhe jo konform kuadrit ligjor për përcaktimin e mesatares 7.5 ose më lartë. Në vitin e dytë shohim një trend rritës të regjistrimit në vitin akademik 2023-2024, <b>80 studentë të regjistruar</b> por që sërish mesatarja e tyre është nën kriterin e përcaktuar <sup>246</sup> 7.5 e lartë për degët e mësuesisë. Ky përbën një problem serioz që duhet adresuar nga institucioni.

<sup>244</sup> Evidenca. Aneks-Tabelat Përmbledhëse

<sup>245</sup> Evidenca. Aneks-Tabelat Përmbledhëse

<sup>246</sup> Vendim Nr.46, Datë 27.1.2021 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore disponon të dhënat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, nëse ka pasur tërheqje nga programi, largime, mospërfundim me sukses të programit. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program për vitin akademik 2022-2023 është 49, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 është 80 studentë. Mesataret hyrëse janë nën 7.5 duke thyer përcaktimin e mesatareve për degët e mësuesisë sipas kuadrit ligjor në fuqi<sup>247</sup>. Pavarësisht, kësaj thyerje, QSHA ka matrikulluar studentët e vitit të parë. Siç vihet re, numri i studentëve në vitin e e dytë të ofrimit të programit është përafërsisht 39% më i lartë, dhe mesataret hyrëse të studentëve janë 6.2.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin e informacionit në lidhje me studentët sipas programeve përkatëse si dhe me të dhënat statistikore nga hyrja deri në dalje të studentëve nga programi<sup>248</sup>. Sekretaria menaxhon të dhënat e studentëve nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit të brendshëm, që është Portali Studentor<sup>249</sup>. Personat e autorizuar përdorin sistemin për të gjeneruar statistika mbi studentët dhe për t'u informuar në mënyrë të shpejtë mbi arritjet e studentëve apo informacione të tjera të nevojshme.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Në bashkëpunim me Zyrën e Cilësisë së Brendshme të UniBa dhe Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe të Programeve, planifikohen kontrolle periodike, të cilat janë përcaktuar edhe në rregulloret e institucionit<sup>250251</sup>. GVJ, nga vizita në sekretarinë mësimore konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi. Një problem shqetësues për stafin e sekretarisë mësimore ishte mungesa e regjistrimit themeltar nga QSHA.</p>

<sup>247</sup> Vendim Nr.46, Datë 27.1.2021 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf>

<sup>248</sup> Evidenca 19.1 Rregullore e sekretarisë

<sup>249</sup> Evidenca 38.i Manuali i Portalit Studentor për administrim

<sup>250</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë

<sup>251</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa



veprimtarinë e tyre përkatëse.	
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>DSHETP harton raporte analitike dhe periodike ku fokusi bie tek arritjet e departamentit, bashkëpunimet ndërkombëtare, avancimin e stafit akademik si dhe marrjen e patentave, trajnimeve në funksion të rritjes së cilësisë së programeve që departamenti ofron dhe më pas bëhet një analizë SËOT. Në raportin e DSHETP nuk rezultojnë një analizë e profilit hyrës të studentëve, ku për këtë program studimi vihet re një mesatare hyrëse nën kufinj të përcaktuar ligjor për mesataret hyrëse në programet e mësuesisë<sup>252</sup>. Në raportin vjetor të UniBa<sup>253</sup> raportohet mbi gjurmimin e studentëve, si dhe punësimit të tyre<sup>254</sup>. Gjithashtu, në këtë raport bëhet një analizë e mesatares së studentëve të vitit akademik 2022-2023, ku raportohet se mestrarja e grupit është 8.1, gjë që tregon një rritje të lartë në krahasim me profilin e tyre hyrës që është 6. Një shpjegim për këtë rritje të mesatares nuk është dhënë në raport. Aftësimi i studentëve për tregun e punës është në vëmendje të institucionit. UniBa ka krijuar një sërë shërbimesh dhe aktivitets në funksion të rritjes së shanceve për punësim të studentëve<sup>255</sup><sup>256</sup><sup>257</sup>, të cilat sugjerohen të specifikohen në çdo program studimi që ofrohet. Ndërkohë, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në takimin me studentët, shqetësimin e tyre për emërimin si mësues ndihmës dhe jo si mësues të arsimit special. Sipas tyre, ky emërim krijonte një pozicion inferior në vendin e punës dhe që reflektohej me kushte të punës më pak të favorshme dhe rrogë më të ulët. Sipas tyre duhet t'i jepet prioritet statusit të mësuesit të arsimit special, pasi ato nuk janë në mbështetje të mësuesve të tjerë, por janë vetë mësues për kategori nxënës me zhvillim ndryshe. Ky shqetësim i tyre nuk reflektohet në raportet periodike për vlerësimin e programit, por që duhet të marrë në konsideratë për të zhvilluar më tej karrierën e tyre profesionale në këtë drejtim të mësuesisë.</p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konfirmon se institucioni ka sistem për menaxhimin e të dhënave që përdoret nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët, vlerësimet dhe profilin e studentëve që ndjekin</i></p>

<sup>252</sup> Vendim Nr.46, Datë 27.1.2021 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/1.-vendim-2021-01-27-46.pdf>

<sup>253</sup> Evidenca A.1 38 Raporti vjetor UniBa 2022-2023

<sup>255</sup> <https://humancapital.al/>

<sup>256</sup> Evidenca 20.2. Strategjia e Klubeve Studentore 2020-2025

<sup>257</sup> <https://students.umb.edu.al/news5650.html>



	<i>programin e studimit Master Profesional në Arsim Special. Të dhënat ruhen edhe në regjistra të posaçëm nga pranimi dhe regjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu institucioni disponon të dhëna edhe për punësimin e studentëve. Por GVJ konstatoi se raportet periodike pavarësisht se reflektojnë prirje për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së procesit mësimor, kërkohet që të pasqyrohen më shumë zërat e studentëve për programin studimor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullore të vetë institucionit.	UniBa në statutin <sup>258</sup> e tij dhe rregulloren <sup>259</sup> e tij parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse si Senati Akademik, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Standarteve të cilësisë <sup>260</sup> , Dekanatit të Fakultetit, përfaqësimit të studentëve në mbledhjet e departamentit, të mbështetjes institucionale në formimin e qeverisë studentore <sup>261</sup> si dhe angazhimin e tyre në GVB. Përfshirja e studentëve apo e përfaqësuesve të tyre përcaktohet në aktet ligjore por edhe rregulloreve të vetë institucionit <sup>262263264265</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të	Institucioni garanton përfshirjen studentore në strukturat vendimmarrëse sipas kuadrit ligjor dhe rregullator të tij <sup>266267268</sup> , duke përcaktuar përfaqësues studentor në Senatin Akademik, në

<sup>258</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>259</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa

<sup>260</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>261</sup> Evidenca 20.1 Rregullore Qeveria Studentore

<sup>262</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa

<sup>263</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>264</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>265</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

<sup>266</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>267</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>268</sup> Evidenca 20.1 Rregullore Qeveria Studentore

<p>tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë<sup>269</sup>, dhe pjesë e GVB. Gjithashtu, UniBa ka krijuar struktura studentore për të mbështetur zhvillimin e aftësive të tyre profesionale por edhe të forcimit të rrjeteve studentore duke fuqizuar zërin e tyre<sup>270271</sup>. Gjatë procesit të vlerësimit të stafit akademik, studentët luajnë një rol të rëndësishëm pasi angazhohen në vlerësimin e pedagogëve të programeve lëndore duke pasur impakt në procesin e cilësisë së mësimdhënies<sup>272</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në institucion si me stafin akademik, përgjegjës in e departamentit dhe me studentët, rezulton se studentët organizonin fokus grupe me stafin akademik, ose përfshiheshin në diskutime të DSHETP për procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit ku diskutimet më së shumti ishin mbi organizimin e lëndëve, metodave të mësimdhënies demonstrative. Gjithashtu, studentët vazhdimisht vlerësojnë programin studimor dhe mësimdhënien me anën e vlerësimeve të vazhdueshme<sup>273</sup>. Gjithashtu, studentët e programit studimor kishin mundësi të komunikonin në mënyrë të vazhdueshme për çdo sugjerim, apo përmirësim në procesit të mësimdhënies me koordinatoren e njësisë bazë<sup>274</sup>, e më pas koordinatori reflektonte shqetësimet e studentëve në njësinë përgjegjëse, por në evidencë nuk përcaktohet një koordinator i programit studimor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe</p>	<p>Procesi i vlerësimit dhe kontrollimit të dijeve është i rregulluar si në nivel institucioni<sup>275276277</sup>, njësie kryesore<sup>278</sup> dhe njësie bazë<sup>279</sup>. Rregulloret e brendshme të institucionit, por dhe ajo e programit të studimit ju mundësojnë studentëve një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Sipas rregullores së UniBa<sup>280</sup> provimet sekretohen nga sekretaria, dhe këto provime hapen pas korrigjimit nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve të vlerësimit të studentëve. Studenti ka të drejtë të ankimimit për provimin dhe procedura e ankimimit</p>

<sup>269</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>270</sup> Evidenca 20.3. Manuali i Klubeve Studentore

<sup>271</sup> <https://students.umb.edu.al/qeveria-studentore.html>

<sup>272</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>273</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>274</sup> Evidenca 47. Urdhër i Brendshëm Nr. 29. Emërim Koordinatori

<sup>275</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa

<sup>276</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>277</sup> Evidenca 19.1. Rregullore e sekretarisë mësimore

<sup>278</sup> Evidenca 1. Rregullore e Fakultetit FSHSTS

<sup>279</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

<sup>280</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa

reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	rregullohet sipas Nenit 89 të rregullores UniBa. Nga vizita e GVJ në institucion dhe takimi me studentët, rezulton se studentët janë shumë të qartë për procesin e vlerësimit dhe kontrollimit të dijeve dhe nuk kishin pasur raste ankimimi, por ishin të qartë se si do të vepronin në rast se do të bënin një procedurë të tillë.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ nga DVV dhe nga vizita në institucion del në përfundimin se institucioni kishte të ndërtuar kuadrin rregullator për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, dhe nga takimi me studentë u evidentuan raste kur ata ishin të përfshirë në procesin e hartimit, miratimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit. Gjithashtu, institucioni UniBa ka krijuar procedura transparente të vlerësimit dhe kontrollimit të dijeve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UniBa në mbështetje të studentëve ka krijuar një infrastrukturë dhe mekanizma specifik në funksion të informimit, dhënies së shërbimeve për studentët, sipas parashikimeve ligjore <sup>281</sup> dhe akteve rregullatore <sup>282283284</sup> të institucionit. UniBa vë në dispozicion disa zyra të rëndësishme për të ofruar shërbim për studentët si Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra Alumni dhe Karriera, Biblioteka, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë. si dhe një tërësi klubesh studentore <sup>285</sup> që kanë si qëllim orientimin dhe përshtatjen e studentëve me jetën studentore. Këto struktura ofrojnë shërbime të nevojshme dhe mbështetëse për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në UniBa dhe vijojnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes

<sup>281</sup> Ligji Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë [https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/AKTET\\_NENLIGJORE.pdf](https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/AKTET_NENLIGJORE.pdf)

<sup>282</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa

<sup>283</sup> Evidenca 20. Rregullore e zyrave studentore

<sup>284</sup> Evidenca 20.1 Rregullore Qeveria Studentore

<sup>285</sup> <https://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html>

	shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj. Gjithashtu, UniBa ka krijuar një agjenci punësimi <sup>286</sup> , Barleti Human Capital, që ka si qëllim të krijojë një urë midis Alumnit të tij dhe tregut të punës, me anën e promovimit të ofertave të punës, trajnimeve profesionale, mbështetje për start-up etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UniBa vë në dispozicion disa zyra të rëndësishme për të ofruar këshillim, asistim, ndjekje dhe përparimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra Alumni dhe Karriera, Biblioteka, kanë si qëllim orientimin dhe asistimin e studentëve gjatë procesit mësimor dhe më tej në mbështetjen për t'u përqasur në tregun e punës. UniBa me anën e agjencisë Barleti Human Capital <sup>287</sup> ka si qëllim të mbështes Alumnin e tij në tregun e punës, me anën e promovimit të ofertave të punës, trajnimeve profesionale, mbështetje për start-up etj.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në UniBa Zyra Alumni, Karriera dhe Dekani i Studentëve u ofronin studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Alumnit dhe Karrierës ka krijuar një bazë të dhënash për Alumnin <sup>288</sup> . Gjithashtu, UniBa mbështet këshillimin e karrierës të studentëve duke organizuar edhe aktivitete nga Zyra Alumni <sup>289</sup> , Klubi i Karrierës <sup>290</sup> dhe aktiviteteve të organizuara nga agjencia e punësimit Barleti Human Capital <sup>291</sup> . Kjo agjenci mbështet studentët dhe Alumnin në ofertën e punës, asistimin për aplikim për punë, organizimin e seminareve dhe uorkshopeve në ndihmë të procesit të punësimit, praktikave profesionale etj.
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të	UniBa nëpërmjet Zyrës Alumni dhe Karriera ndjek studentët pas diplomimit, mbledh dhe përpunon statistika mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Këto statistika raportohen në raportet

<sup>286</sup> <https://humancapital.al/>

<sup>287</sup> <https://humancapital.al/>

<sup>288</sup> Raporti Alumni <https://umb.edu.al/upload/pdf/Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf>

<sup>289</sup> Evidencë 22.2 Raport Alumni

<sup>290</sup> <https://students.umb.edu.al/klubi-i-karrieres.html>

<sup>291</sup> <https://humancapital.al/>

dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	vjetore të institucionit <sup>292293</sup> , dhe të Zyrës Alumni dhe Karrierës <sup>294</sup> . Zyra e Alumni dhe Karrierës bashkëpunon me Agjensinë e Punësimit Human Capital Barleti, në mënyrë që shërbimi për studentët dhe Alumnin si dhe gjurmimi i tyre të jetë në funksion të punësimit.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Si përfundim, UniBa garanton mekanizma rregullator dhe ofron shërbime me anën e zyrave të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, asistimin e studentëve në problematikat e tyre përreth vlerësimit, kontrollit të dijeve apo procesit studimore. Këto mekanizma janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit e shërbimet ofrohen nga një tërësi zyrash në funksion të studentëve si zyra e pranimit, sekretaria mësimore, zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumnit dhe Karrierës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për</b>	UniBa ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies për programet studimore që ofron <sup>295</sup> si dhe udhëzues për të mbështetur studentët në përdorimin e

<sup>292</sup> Raporti Alumni, të dhënat statistikore <https://umb.edu.al/upload/pdf/Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf>

<sup>293</sup> Evidencë A.1. 38 Raporti Vjetor UniBa për vitin akademik 2022-2023

<sup>294</sup> Evidencë 22.2 Raport Alumni

<sup>295</sup> Evidenca 11. Udhëzues për metodat e mësimdhënies

<p>zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>programeve online për mësimdhënien apo përdorimin e teknologjisë së informacionit<sup>296</sup>. Institucioni ka miratur Komisionin e Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, i cili është një organ kolegjal që kryen sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit, duke siguruar standartet shtetërore të cilësisë të parashikuara në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kuadrit ligjor që rregullojnë elementët e programeve të studimit<sup>297</sup>. UniBa ka struktura përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të cilat janë: Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë dhe koordinatori institucional<sup>298</sup>, Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Komisioni i Vlerësimit të Performancës<sup>299</sup>, Senati Akademik, koordinatorët e njësive bazë, si dhe Grupet e Vlerësimit të Brendshëm. Por, nga DVV, por edhe nga vizita në institucion, nuk është përcaktuar një koordinator i programit studimor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Strukturat kryesore të monitorimit dhe vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe personelit akademik dhe ndihmës akademik në UniBa janë Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Komisioni i Vlerësimit të Performancës dhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Përmes rregullores së Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë<sup>300</sup>, Rregullores së Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave<sup>301302</sup> dhe Cilësisë dhe Vlerësimit të Performancës<sup>303</sup> synohet të sigurohen standardet e cilësisë duke krijuar vlerësime të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë të UniBa së bashku me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë<sup>304</sup>, vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së studentëve, vlerësimin e cilësisë së personelit<sup>305</sup>. Pjesë të këtyre veprimtarive janë zyra e burimeve njerëzore, njësitë për kërkimin shkencor, fakultetet, departamentet dhe zyrat për studentët dhe koordinatorët institucional dhe të njësive bazë. Bazuar në informacionin e paraqitur në DVV dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se bëhen vlerësime të</p>

<sup>296</sup> Evidenca 17.3 Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa

<sup>297</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>298</sup> Evidenca 48.1 Të dhënat tabelore për angazhimin në siguri të cilësisë

<sup>299</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës

<sup>300</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>301</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>302</sup> Evidenca 48. Plan Pune NJZHKC

<sup>303</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës

<sup>304</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>305</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

	vazhdueshme për të monitoruar cilësinë e brendshme të institucionit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët në UniBa përfshihen në vlerësimin periodik për cilësinë e mësimdhënies, programit dhe vlerësimin e dijeve <sup>306307308309</sup> . Studentët në plotësimin e pyetësorëve vlerësojnë si pedagogun, programin lëndor, kurrikulën dhe problematikat e tyre gjatë procesit mësimor duke përfshirë edhe trajtimin e ankesave. Rezultatet e këtyre sondazheve iu vihen në dispozicion drejtuesit të njësisë kryesore dhe përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Duke iu referuar DVV dhe vizitës në institucion, rezulton se mekanizmat monitorues dhe kontrollues janë transparente dhe i bëhen publike stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Gjithashtu GVJ konstatoi se institucioni është i interesuar të vlerësojë cilësinë, ta raportojë atë duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave <sup>310311</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UniBa vazhdimisht promovon shembuj të studentëve që kanë studiuar në programe të ndryshme studimi duke përdorur faqen e ëebit dhe rrjetet sociale <sup>312</sup> . Gjithashtu, UniBa promovon vazhdimisht studentët në revistën studentore ku reflektohen aktivitetet e ndryshme të studentëve dhe Alumnit <sup>313</sup> . Në to paraqiten rastet e studentëve më ekselentë në programe të ndryshme studimit, modele të suksesit profesional dhe angazhimi i studentëve aktual në komisione drejtuese të institucionit, klube të ndryshme studentore dhe përfaqësimet e tyre si ambasadorë të universitetit. Nga vizita në institucion, rezulton se raportet e vlerësimit të brendshëm përdoren nga institucioni për të përmirësuar cilësinë e programit të studimit si dhe për të trajnuar stafin për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
<b>Konkluzione</b>	<i>UniBa është e angazhuar të ndjekë një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nëpërmjet strukturave të tij monitoruese ka hartuar rregullore,</i>

<sup>306</sup> Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studentëve për lëndën semII

<sup>307</sup> Evidenca 16.6 Formulari për transparencën e vlerësimit

<sup>308</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>309</sup> Evidenca 16.7 Raport mbi rezultatet e formularit të studentëve semI

<sup>310</sup> Evidenca 16.7 Raport mbi rezultatet e formularit të studentëve semI

<sup>311</sup> Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studentëve për lëndën semII

<sup>312</sup> <https://students.umb.edu.al/>

<sup>313</sup> <https://students.umb.edu.al/revista-studentore.html>

	<i>udhëzues për zhvillimin e mësimdhënies cilësore si dhe për procedurat e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së brendshme.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në statutin e institucionit <sup>314</sup> dhe rregulloren e tij <sup>315</sup> përcaktohen strukturat përkatëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe me aktet rregullatore institucionale <sup>316317318</sup> . UniBa nëpërmjet Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, Komisionit të Vlerësimit të Performancës, Këshillit të Etikës dhe Shanseve të Barabarta, dhe strukturave të tjera drejtuese si Senati Akademik, njësia bazë dhe kryesore, realizojnë procesin e SBC.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UniBa ka struktura të ngritura që bëjnë të mundur funksionimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë <sup>319320321</sup> . Vizioni i institucionit është të krijohet një institucion i arsimit të lartë cilësor, inovator e i orientuar drejt tregut të punës <sup>322</sup> . Misioni i institucionit është të përgatisë studentë me nivel të lartë profesionalizmi, të aftë për të menaxhuar sfidat profesionale, të jenë qytetar aktiv. Gjithashtu, UniBa synon që të ofrojë një ofertë akademike ku prioritet janë mësimdhënia cilësore aktive dhe kërkimi shkencor i aplikuar. Për të ndjekur këtë mision dhe vizion, UniBa në nivel institucional ka krijuar struktura përgjegjëse për SBC që janë: Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Koordinatorin Institucional, Njësinë e

<sup>314</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Barleti

<sup>315</sup> Evidenca 1.2 Rregullore UniBa

<sup>316</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>317</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës

<sup>318</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë

<sup>319</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë

<sup>320</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>321</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës

<sup>322</sup> Evidenca 10. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030



	<p>Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Komisionin e Vlerësimit të Performancës, Koordinatorët e njësive bazë si dhe Grupet e vlerësimit të Brendshëm. Ligji për Arsimin e Lartë përcakton krijimin e një Njësie për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NjBSC) për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e kërkesave arsimore. Në UniBa rolin e NjBSC-së e realizon Njësia e Zhvillimi të Kurrikulave dhe Cilësisë. Në nivel fakulteti, sigurimi i cilësisë ndodh nëpërmjet grupeve të vlerësimit të brendshëm, në të cilët ka përfaqësues të studentëve si dhe koordinatorët e njësive bazë që bashkërendojnë punën në funksion të sigurimit të cilësisë me grupet e vlerësimit të brendshëm, departamentit, njësisë kryesore dhe strukturave të tjera drejtuese. Gjithsesi, GVJ konstatoi se nuk rezulton që programet studimore të kenë koordinatorët përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor një paketë instrumentash dhe treguesish të përshtatshëm për të garantuar sigurimin e cilësisë<sup>323324325</sup>. UniBa ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL dhe po i nënshtrohet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit të programit studimor. Gjithashtu, UniBa i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional duke marrë akreditim institucional për një periudhë kohore 5 vjeçare<sup>326</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim,</p>	<p>UniBa ka një sërë treguesish të matshëm në mësimdhënie<sup>327328329330331332333</sup> dhe kërkim<sup>334335</sup> që mbështesin gjendjen aktuale, arritjet, dobësitë e procesit mësimor dhe</p>

<sup>323</sup> Evidenca 16.6 Formulari për transparencën e vlerësimit

<sup>324</sup> Evidenca 16.5 Formular i vlerësimit koleg me koleg

<sup>325</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>326</sup> Evidenca 1.4. Vendim i Bordit të Akreditimit 2021

<sup>327</sup> Evidenca 16.7 Raport mbi rezultatet e formularit të studentëve

<sup>328</sup> Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studentëve për lëndën

<sup>329</sup> Evidenca 16.6 Formulari për transparencën e vlerësimit

<sup>330</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>331</sup> Evidenca 16.5 Formular i vlerësimit koleg me koleg

<sup>332</sup> Evidenca-Vlerësimi i Shefit të Departamentit

<sup>333</sup> Evidenca 32.c Të dhënat mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve Erasmus

<sup>334</sup> Evidenca-Mekanizmat Institucional të Universitetit Barleti për Mbështetjen e Aktivitetit Kërkimor të Stafit Akademik

<sup>335</sup> Evidenca A.1.39 Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa 2022-2023

për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	kërkimor <sup>336</sup> , të cilat janë parashikuar në aktet rregullatore <sup>337338339</sup> . Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë sigurojnë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik <sup>340</sup> dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore <sup>341</sup> , ndërkombëtarizimin <sup>342</sup> përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët <sup>343</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>UniBa garanton sigurimin e cilësisë me anën e hartimit dhe zbatimit të politikave, procedurave, akteve rregullatore, strukturave institucionale, të cilat periodikisht vlerësojnë procesin e mësimdhënies, kërkimor dhe dhënien e shërbimeve cilësore, e të cilat pasqyrohen edhe në programin e studimit master profesional në arsim special.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë	Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë dhe Zyra e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës, monitorojnë punën e departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikqyrëse që i shërben akreditimit të tij, duke pasqyruar arritjet,

<sup>336</sup> Evidenca 35.a Raport vjetor i Departamentit 2022-2023

<sup>337</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë

<sup>338</sup> Evidenca A1.41. Manuali i Cilësisë

<sup>339</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësive të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>340</sup> Evidenca A.1. 15 Formular-Raportim i Punës Semestrare të Pedagogut

<sup>341</sup> Evidenca-Projekte për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar

<sup>342</sup> Evidenca 10.1 Strategjia e Ndërkombëtarizimit UniBa

<sup>343</sup> Evidenca 32.c Të dhënat mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve Erasmus

<p>akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>dobësitë, praktikat e mira dhe planin për përmirësim<sup>344345346347348</sup>. Institucioni ka hartuar një plan strategjik<sup>349</sup>, i cili pasqyron rëndësinë e cilësisë së mësimdhënies inovatore, ndëraktive, me në qendër studentin, të përparimit të shkencës në funksion të shoqërisë. Gjithastu institucioni për të mbështetur këtë mision dhe për të garantuar sigurimin e cilësisë ka hartuar edhe një strategji për ndërkombëtarizimin institucional<sup>350</sup>, duke pasur pikësynim avancimin e dijes dhe shkencës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në raportin e vjetor të Vlerësimit të Cilësisë në UniBa<sup>351</sup> pasqyrohen rezultatet e arritura, realizimi i objektivave, bëhet analizë për mekanizmat rregullatorë të sigurimit të cilësisë dhe jepen rekomandime për përmirësim të praktikave në të ardhmen. Gjithashtu edhe në raporte të tjera periodike evidentojmë këtë strukturë vlerësimi<sup>352</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>UniBa për kryerjen e vlerësimit, përdor instrumente si: pyetësori i studentëve<sup>353354355356</sup>, vlerësime të stafit nga njësia bazë<sup>357358</sup>,</p>

<sup>344</sup> Evidenca 48. Plan Pune NJZHKC

<sup>345</sup> Evidenca A.1. 15 Formular-Raportim i Punës Semestrare të Pedagogut

<sup>346</sup> Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studentëve për lëndën

<sup>347</sup> Evidenca 35.a Raport vjetor i Departamentit 2022-2023

<sup>348</sup> Evidenca A.1.39 Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa 2022-2023

<sup>349</sup> Evidenca 10. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030

<sup>350</sup> Evidenca 10.1 Strategjia e Ndërkombëtarizimit UniBa

<sup>351</sup> Evidenca A.1.39 Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa 2022-2023

<sup>352</sup> Evidenca 35.a Raport vjetor i Departamentit 2022-2023

<sup>353</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>354</sup> Evidenca 16.7 Raport mbi rezultatet e formularit të studentëve

<sup>355</sup> Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studentëve për lëndën

<sup>356</sup> Evidenca 16.6 Formulari për transparencën e vlerësimit

<sup>357</sup> Evidenca A.1. 15 Formular-Raportim i Punës Semestrare të Pedagogut

<sup>358</sup> Evidenca-Vlerësimi i Shefit të Departamentit

<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>vlerësime të stafit nga njëri-tjetri<sup>359</sup>. Instrumentat masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.<sup>360</sup><sup>361</sup><sup>362</sup><sup>363</sup> Gjithashtu, për vlerësimin e programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së programit<sup>364</sup>, provimet<sup>365</sup>, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që</p>	<p>UniBa përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët realizuara me studentët <sup>366</sup>, të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit<sup>367</sup><sup>368</sup>. Gjithashtu, njësia bazë realizon vlerësimin e performacës së pedagogut nga përgjegjësi i departamentit <sup>369</sup><sup>370</sup>. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit për të mbështetur zhvillimin e cilësisë së procesit mësimor-kërkimor në të ardhmen.</p>

<sup>359</sup> Evidenca 16.5 Formular i vlerësimit koleg me koleg

<sup>360</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>361</sup> Evidenca A.1.39 Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa 2022-2023

<sup>362</sup> Evidenca 12.a Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës

<sup>363</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>364</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>365</sup> Evidenca 2.6.a Teza e Provimit Përfundimtar

<sup>366</sup> Formular i vlerësimit të studentëve për lëndën

<sup>367</sup> Evidenca 16.7 Raport mbi rezultatet e formularit të studentëve semI

<sup>368</sup> Evidenca 16.8. Raport me vlerësimin e studentëve për lëndën semII

<sup>369</sup> Evidenca-Vlerësimi i Shefit të Departamentit

<sup>370</sup> Evidenca A.1. 15 Formular-Raportim i Punës Semestrale të Pedagogut



bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
<b>Konkluzione</b>	<i>Universiteti Barleti ka krijuar njësi dhe struktura për të monitoruar dhe vlerësuar programin e studimit, për të arritur objektivat formuese dhe të të nxëniet. Gjithashtu, ky monitorim në mënyrë periodike ndodh edhe tek stafi akademik si në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të tërthortë, duke mbështetur procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UniBa ka hartuar politika dhe procedura që mbështesin sigurimin e brendshëm të cilësisë <sup>371372373374</sup> , duke përfshirë aktorë të brendshëm si koordinatoren institucional dhe koordinatorët e njësive bazë, si dhe grupet e vlerësimit të brendshëm. GVJ konstaton se UniBa dhe njësia bazë kanë bërë marrëveshje bashkëpunimi si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar që nxisin bashkëpunime me ekspertë të jashtëm e duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme parametrat e cilësisë <sup>375376377</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe	UniBa përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e

<sup>371</sup> Evidenca A1.41. Manuali i Cilësisë

<sup>372</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësive të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>373</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>374</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës

<sup>375</sup> Evidenca 32.c Të dhënat mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve Erasmus

<sup>376</sup> Të dhënat mbi marrëveshjet e bashkëpunimit

<sup>377</sup> Evidenca 22. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të departamentit

<p>detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>brendshëm të cilësisë së programit të studimit, të cilat janë parashikuar në kuadrin rregullator të saj<sup>378379380381382</sup>. GVJ duke u bazuar në këtë dokumentacion rregullator që mbështet funksionimin e brendshëm të cilësisë dhe atë të siguruar në takimet gjatë vizitës në institucion, del në konkluzionin se detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloret për ruajtjen e cilësisë dhe në rregulloren e programit studimor. Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Njësia për Zhvillimin e Kurrikulës dhe Cilësisë si dhe Zyra e Vlerësimit dhe e Performancës, së bashku me koordinatorët e njësive bazë dhe grupet e vlerësimit të brendshëm për çdo program studimor, garantojnë punën periodike të sigurimit të cilësisë së brendshme duke angazhuar njësitë përkatëse, stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si dhe studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UniBa në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë si dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit ka përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë<sup>383</sup>. Gjithashtu, njësia bazë përfshihet në procesin e sigurimit të cilësisë së brendshme duke asistuar në dhënien e dokumentave të nevojshme grupit të vlerësimit të brendshëm. Ndërsa, personeli ndihmës akademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që nevojiten për DVV. Gjatë takimeve me stafin akademik, administrativ dhe studentët, u shprehën se janë pjesëmarrës në hartimin dhe plotësimin e pyetësorve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet akteve rregullatore për garantimin e cilësisë respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, duke garantuar pjesëmarrje të drejtë, të barabartë si dhe duke adresuar problemet që identifikohen me anën e plotësimit të instrumentave</p>

<sup>378</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë

<sup>379</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësive të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>380</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës

<sup>381</sup> Evidenca A1.41. Manuali i Cilësisë

<sup>382</sup> Evidenca 3. Rregullore e programit MPMAS

<sup>383</sup> Evidenca 48.1 Të dhënat tabelore për angazhimin në siguri të cilësisë

	vlerësues <sup>384</sup> dhe sigurisht duke ju mundësuar edhe instrument të adresimit të shqetësimeve <sup>385386</sup> .			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVB përbëhet nga punonjës të stafit akademik dhe ndihmës akademik administrativ, si dhe një përfaqësuesi nga studentët <sup>387</sup> . Organizimi i GVB me ekspertë të jashtëm që departamenti bashkëpunon do të jepte mundësinë për të realizuar një vlerësim të programit tërësor duke garantuar më shumë objektivitet dhe adresim të problematikave që vihen re në sigurimin e cilësisë së programit. GVJ rekomandon që të krijohen më shumë hapësirë për ekspertët e jashtëm me të cilët institucioni bashkëpunon për zbatimin e programit, e që do të kontribuonin më tej në qëndrueshmërinë e programit studimor.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se UniBa në SBC-së ka krijuar mekanizma rregullator dhe procedura që përfshijnë njësitë akademike, personelin akademik, administrativ, studentët përfshirë dhe studentët e programit të studimit. Këto njësi të SBC-së informojnë periodikisht palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm	UniBa në faqen zyrtare të internetit ka bërë publike veprimtarinë e ndërmarrë për SBC duke publikuar një sërë aktiviteteve, vendimesh të strukturave drejtuese, e duke përfshirë edhe raportin vjetor për sigurimin e cilësisë <sup>388389</sup> , duke krijuar mekanizma transparent të publikimit të veprimtarisë për SBC-së.

<sup>384</sup> Evidenca 33.a Rregullore e Këshillit të Etikës dhe Shanseve të Barabarta

<sup>385</sup> Evidenca A.1.39 Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa 2022-2023

<sup>386</sup> Evidenca A1.41. Manuali i Cilësisë

<sup>387</sup> Evidenca A.3. 20 Urdhër për Ngritjen e GVB

<sup>388</sup> <https://umb.edu.al/dossier-UniBa.html>

<sup>389</sup> <https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html>

të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UniBa në Kodin e Etikës <sup>390</sup> shprehet qartë për garantimin e lirisë dhe etikës akademike, si dhe ruajtjes së konfidencialitetit për të dhënat personale. GVJ konfirmon se në raportet dhe dokumentat e vlerësimit të SBC-së të publikuara në faqen zyrtare për vlerësimin e sigurisë së institucionit, është respektuar liria dhe etika akademike <sup>391</sup> dhe është siguruar konfidencialiteti <sup>392</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor për vlerësimin e SBC-së shoqërohet me një plan masash që i adresohen dobësive të evidentuara dhe rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm <sup>393</sup> . Në raportin vjetor të departamentit është bërë një analizë SWOT duke theksuar pikat e forta dhe të dobëta në vlerësimin e punës mësimore-shkencore të departamentit si dhe vlerësimin e programit studimor <sup>394</sup> . Gjithashtu, në raportin e vlerësimit të brendshëm, grupi i punës ka paraqitur kufizime të programit studimor që duhen konsideruar për përmirësim të mëtejshëm <sup>395</sup> . Ndërsa në raportin vjetor të UniBa ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta, dhe nuk shfaqet një evidentim i kufizimeve dhe rekomandimeve të mëtejshme për progres institucional <sup>396</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në	UniBa për të monitoruar vlerësimin e cilësisë ka krijuar struktura përgjegjëse si Komisioni i Sigurimit të Standardave të Cilësisë <sup>397</sup> , Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë <sup>398</sup> , Zyrën e Vlerësimit të Performancës <sup>399</sup> . Gjithashtu, UniBa ka krijuar grupe të vlerësimit të brendshëm për të bërë raportet për programet e studimit. Këto raporte përdoren nga institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

<sup>390</sup> Evidenca A.1.5 Kodi Etikës UniBa

<sup>391</sup> Evidenca 6. Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike dhe financiare

<sup>392</sup> <https://umb.edu.al/dossier-UniBa.html>

<sup>393</sup> Evidenca A.1.39 Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa 2022-2023

<sup>394</sup> Evidenca 35.a Raport vjetor i Departamentit 2022-2023

<sup>395</sup> RVB Arsimit Special

<sup>396</sup> Evidenca A.1 38 Raporti Vjetor UniBa Viti Akademik 2022-2023

<sup>397</sup> Evidenca 17. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë

<sup>398</sup> Evidenca 16.2 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë

<sup>399</sup> Evidenca 12.a Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancë



vijim të cilësisë së programit të studimit.									
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë së bashku me Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, Zyrën e Vlerësimit të Performancës, organizojnë veprimtari periodike me personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, dhe studentët, për ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. GVJ gjatë vizitave konstatoi se raportet e vlerësimit ndaheshin me aktorët përkatës duke ruajtur konfidencialitetin, lirinë dhe etikën akademike, por nga ana tjetër duke adresuar problematika të ndryshme të evidentuara gjatë procesit, duke ndihmuar në mbështetjen e stafit dhe progresin e studentëve <sup>400401402403</sup> .								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ arrin në konkluzionin se UniBa me anën e politikave, procedurave, akteve rregullatore, për vlerësimin e SBC-së për programin e studimit, angazhohet në mënyrë të qëndrueshme, duke i bërë raportet publike, transparente dhe duke nxitur një kulturë të sigurimit të cilësisë institucionale, duke përmbushur plotësisht standartin.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<sup>400</sup> <https://www.umb.edu.al/news4901.html>

<sup>401</sup> <https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html>

<sup>402</sup> <https://umb.edu.al/mps.html>

<sup>403</sup> <https://umb.edu.al/news5314.html>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Arsim Special”, ofruar nga Universiteti “Barleti”**

**Pika të forta dhe afirmime**

1. Stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, në UniBa ka shfaqur angazhim maksimal gjatë vizitave të GVJ. Pavarësisht, problematikave të evidentuara me kushtet e punës të stafit në UniBa (**shih Standartin IV**), ky dedikim i stafit dhe motivacion i lartë në punë është një burim njerëzor që kontribuon në progresin e programit studimor.
2. UniBa ka krijuar një infrastrukturë bashkëkohore që garanton cilësi në procesin mësimor-kërkimor (**Shih Standartin IV**).
3. UniBa ka hartuar mekanizma semestralë për SBC-së (**Shih Standartin VI**).

**Pika të dobta**

1. Një ndër pikat e dobta të programit është një dokumentacion, në të cilin shfaqen mospërputhje informacionesh, mungesë informacionesh dhe informacione jo të plota (**shih (për shembull shih Standarti I.3, kriteri 4, Standarti II.1, kriteri 4, Standarti II.2, kriteri 2, Standarti III, Standarti IV.1, kriteri 6)**).
2. Një pikë e dobët e programit lidhet me mungesën e përditësimit të silabuseve me literaturën e 5 viteve të fundit, si edhe me mungesën e depozitimit të cikleve të leksioneve të stafit akademik në bibliotekën e universitetit (**shih Standarti IV.3, kriteri 2 dhe 3**).
3. Një pikë tjetër e dobët lidhet me kushtet e punës së stafit akademik, ku vihen re kontrata pune ku nuk specifikohet paga në disa raste, në raste të tjera paga është shumë e ulët. Kushtet e punës jo favorizuese shihen si një pikë e dobët që cënon qëndrueshmërinë e stafit akademik (**shih Standartin IV.1, kriteri 6 dhe 7**).
4. Një pikë shqetësuese në programin studimor është mospërmbatja e kriterit të mesatares për programet e mësuesisë (**shih Standarti V.1, kriteri 3**).

**Rekomandime**

1. Rekomandohet një plan strategjik për qëndrueshmërinë e stafit akademik, transparencë të kushteve të punës, pagesave dhe pozicione të mirëstrukturuara të fokusuara vetëm në funksionet e personelit akademik.
2. Krijimi i një plani strategjik financiar të qëndrueshëm duke pasur burime të tjera të qëndrueshme nga projekte kërkimore, bashkëpunime me partnerë në funksion të misionit dhe vizionit të universitetit

3. Edhe pse infrastruktura është bashkëkohore, biblioteka ka një hapësirë shumë të kufizuar. Rekomandohet krijimi i hapësirave fizike për salla leximi dhe të librit fizik në bibliotekë, marrëveshjeve institucionale për platforma digjitale ku studentët të kenë akses të menjëhershëm në literaturën e kërkuar prej tyre, e kjo literature të jetë e përditësuar.

**Conclusions Regarding the Evaluation of the Program Study of the Second Cycle Professional Master in 'Special Education', Offered by the Higher-educational Institution "Barleti"**

**Strengths and affirmations**

1. The academic, supportive, and administrative staff at the university have shown a high level of engagement during the visits by external evaluators. Despite the problems identified in working conditions and staff qualifications (see **Standard IV**), the staff's dedication is a valuable human resource that contributes to the advancement of the program.
2. UniBa has created a modern infrastructure that guarantees quality in the teaching-research process (see **Standard IV**).
3. Uniba has developed semester mechanisms for SBC (see **Standard VI**).


**Weaknesses**

1. One of the weak points of the program is the documentation that contains inconsistencies, information deficits, and is often incomplete (see e.g. **Standard I.3, c. 4; Standard II.1, c. 4; Standard II.2, c. 2; Standard III and Standard IV.1, c. 6**).
2. Another weakness of the programme is that the inclusion of literature of the last five years has not been refreshed within the syllabus, and the lecture series are not deposited by the academic staff in the university library (see **Standard IV.3, c. 2 and 3**).
3. Another weakness is constituted by the working conditions of the academic staff. Sometimes, the employment contract does not specify a salary, and at other times, the salary is abnormally low. These negative working conditions are considered to be a serious issue that questions the sustainability of the academic staff (see **Standard IV.1, criteria 6 and 7**).
4. A point of concern in the programme is the non-compliance with the criterion of average entry grades of students in the programme (see **Standard V.1, criterion 3**).



## Recommendation

1. It is recommended that the institution develop a strategic plan for the sustainability of academic staff, transparency of working conditions, remuneration and well-structured positions focused exclusively on academic staff functions.
2. Create a sustainable financial strategic plan by having other sustainable resources from research projects, collaborations with partners in function of the mission and vision of the university.
3. Although the infrastructure is modern, the library has very limited space. It is recommended to create physical spaces for reading rooms and physical books in the library and institutional arrangements for digital platforms where students have immediate access to the literature they need.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			X	

